



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

**NR. \_\_\_\_\_, DATË \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2026**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 76/2023, datë 21.09.2023  
“PËR FONDET E PENSIONIT PRIVAT”<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 76/2023, datë 21.09.2023 “Për fondet e pensionit privat”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

**Neni 1, ndryshohet me përmbatje si më poshtë:**

"Neni 1

**Objekti dhe fusha e zbatimit**

1. Ky ligj përcakton kërkesat rregullatore për licencimin, organizimin, funksionimin, administrimin, qeverisjen, mbikëqyrjen dhe ushtrimin e veprimtarisë ndërkufitare të subjekteve që administrojnë fonde të pensionit privat në Republikën e Shqipërisë, si dhe për licencimin dhe veprimtarinë e depozitarëve të aktiveve të fondeve të pensionit privat, në përputhje me parimet e përcaktuara në Direktivën (BE) 2016/2341 (IORP II).
2. Ky ligj ka për qëllim:

---

<sup>1</sup> Ky ligj përafrohet plotësisht direktivën (BE) 2016/2341 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 14 dhjetor 2016, “Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP II)”, numri celex 32016L2341, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 354, datë 23.12.2016, f. 37–85. . Direktivën 2014/50/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 16 prill 2014, “Mbi kërkesat minimale për rritjen e lëvizshmërisë së punëtorëve ndërmjet shteteve anëtare nëpërmjet përmirësimit të fitimit dhe ruajtjes së të drejtave për pensione suplementare” numri celex 32014L0050. Direktivën 98/49/KE e Këshillit, e datës 29 qershor 1998, “Për mbrojtjen e të drejtave të pensioneve suplementare të personave të punësuar dhe të vetëpunësuar që lëvizin brenda Komunitetit.”, numri celex 31998L0049.

- a) mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe përfituesve të skemave të pensionit privat;
- b) administrimin e shëndoshë dhe të kujdesshëm të institucioneve të pensionit profesional;
- c) garantimin e transparencës, administrimin efektiv të rrezikut dhe sistemeve të përshtatshme të qeverisjes dhe kontrollit të brendshëm;
- ç) ruajtjen e stabilitetit dhe integritetit të sektorit të pensioneve private.

3. Ky ligj përcakton rregullat dhe procedurat për:

- a) licencimin, organizimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive administruese dhe të shoqërive të sigurimit të jetës që administrojnë fonde të pensionit privat dhe të pensionit profesional;
- b) krijimin, administrimin dhe veprimtarinë e fondeve të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur dhe të fondeve të pensionit privat me pjesëmarrje të mbyllur, me kontribute të përcaktuara në Republikën e Shqipërisë, si dhe të skemave me përfitime të përcaktuara që administrohen në kuadër të veprimtarisë ndërkufitare;
- c) kërkesat për qeverisjen e subjekteve të licencuara, përfshirë kërkesat e aftësisë dhe përshtatshmërisë, politikat e shpërblimit dhe funksionet kryesore, si funksioni i administrimit të rrezikut, funksioni i auditimit të brendshëm dhe, kur parashikohet, funksioni aktuarial;
- ç) licencimin dhe veprimtarinë e depozitarëve, përfshirë ruajtjen e aktiveve të fondeve të pensionit privat;
- d) kompetencat mbikëqyrëse dhe rregullatore të Autoritetit ndaj shoqërive administruese, fondeve të pensionit privat, depozitarëve dhe subjekteve të tjera të përcaktuara në këtë ligj;
- dh) kërkesat për informimin dhe transparencën ndaj anëtarëve dhe përfituesve, përfshirë informacionin para anëtarësimit dhe informacionin e vazhdueshëm gjatë pjesëmarrjes në skemë;
- e) ushtrimin e veprimtarisë ndërkufitare, përfshirë administrimin dhe transferimin e skemave të pensionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve anëtare të Bashkimit Europian, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

4. Ky ligj zbatohet për shoqëritë administruese, fondet e pensionit privat, institucionet e pensionit profesional, depozitarët e aktiveve të fondeve të pensionit, si dhe për subjektet e tjera që ushtrojnë veprimtari sipas këtij ligji.

5. Referencat në këtë ligj ndaj “fondit të pensionit privat” përfshijnë edhe institucionin e pensionit profesional (IORP), përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

6. Kërkesat e parashikuara për shoqërinë administruese zbatohen edhe ndaj shoqërive të sigurimit të jetës kur ato administrojnë fonde të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur ose me pjesëmarrje të mbyllur, në përputhje me këtë ligj.”

## **Neni 2**

**Pas nenit 1, shtohet neni 1/1, me përmbajtje si më poshtë:**

“Neni 1/1

### **Përfshirjet nga fusha e zbatimit të ligjit**

1. Përfshihen nga fusha e zbatimit të këtij ligji:

- a) institucionet që administrojnë skema të detyrueshme të sigurimeve shoqërore;

- b) subjektet që i nënshtrohen legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë për:
- i. sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm;
  - ii. shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, me përjashtim të veprimtarisë së pensioneve private të parashikuar në nenin 3/1, të këtij ligji, e cila nuk rregullohet nga legjislacioni për sigurimin dhe risigurimin;
  - iii. administratorët e fondeve të investimeve alternative;
  - iv. institucionet e kreditit;
  - v. shoqëritë e shërbimeve të investimit;
- c) institucionet dhe skemat e pensionit që funksionojnë sipas parimit të financimit të drejtpërdrejtë, në të cilat kontributet e pjesëmarrësve përdoren për financimin e menjëhershëm të përfitimeve të pagueshme ndaj përfituesve aktualë, pa krijimin ose akumulimin e aktiveve;
- ç) sipërmarrjet që ofrojnë përfitime pensioni nëpërmjet skemave të rezervave kontabël, ku aktivet nuk janë të ndara nga bilanci i punëdhënësit dhe nuk krijohet fond i veçantë pensioni.
2. Institucionet, subjektet dhe veprimtaritë e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni i nënshtrohen legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.”

### Neni 3

#### **Në nenin 2, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:**

1. Pika 3, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“3. “Anëtar” është individi, i ndryshëm nga përfituesi ose anëtari i mundshëm, i cili i bashkohet fondit të pensionit në bazë të një kontrate anëtarësimi me shoqërinë administruese, në emër dhe në përfitim të të cilit është hapur një llogari pensioni në fondin e pensionit privat dhe që ka të drejtën e përfitimit në të ardhmen nga fondi i pensionit, ose aktiviteti profesional aktual apo i mëparshëm i të cilit, bëhet shkak për lindjen e së drejtës për të përfituar pension, në përputhje me dispozitat e një skeme pensioni privat.”

2. Pika 10, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“10. “Fondi i pensionit privat” është një grup i veçuar aktivesh pa personalitet juridik, i miratuar, i regjistruar nga Autoriteti dhe i administruar nga shoqëria administruese, për llogari të anëtarëve të fondit në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Fondi i pensionit privat mund të jetë me pjesëmarrje të hapur ose me pjesëmarrje të mbyllur.”

3. Pika 26, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“26. “Funksione kryesore” si pjesë e sistemit të qeverisjes së shoqërisë, janë funksionet që ushtrohen nga individë në poste drejtuese, të cilët janë përgjegjës për veprimtaritë thelbësore të shoqërisë administruese, ku përfshihen: drejtuesi i njësisë së administrimit të aktiveve dhe investimeve, drejtuesi i njësisë së administrimit të rrezikut, drejtuesi i njësisë së përputhshmërisë, drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm, drejtuesi i funksionit aktuarial, kur kërkohet sipas dispozitave të këtij ligji dhe, në rastin e depozitarit, drejtuesi i auditimit të brendshëm, drejtuesi i administrimit të riskut dhe drejtuesi i përputhshmërisë.”

6. Pika 36, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“36. 'Veprimtari ndërkufitare' është ushtrimi i veprimtarisë së një skeme pensioni profesional, kur marrëdhënia ndërmjet sponsorit, anëtarëve dhe përfituesve të skemës rregullohet nga legjislacioni i punës dhe i mbrojtjes sociale që rregullon skemat e pensioneve profesionale të një shteti anëtar tjetër, i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës.”

7. Pas pikës 38, shtohen pikat 39 deri në 56, me përmbajtje si vjon:

“39. “Institucion pensioni” është institucioni i pensionit profesional (IORP), pavarësisht formës së tij juridike, i krijuar si një entitet i veçuar nga sponsori ose sponsorët e skemës, që vepron mbi bazën e financimit dhe ka si objekt ofrimin e përfitimeve të pensionit në kuadër të një veprimtarie profesionale, mbi bazën e një marrëveshjeje ose kontrate të lidhur:

- a) individualisht ose kolektivisht ndërmjet një ose më shumë punëdhënësve dhe punëmarrësve ose përfaqësuesve të tyre; ose
- b) individualisht ose kolektivisht me persona të vetëpunësuar, në përputhje me legjislacionin e shtetit anëtar të origjinës dhe të shtetit anëtar pritës.

40. “Skemë pensioni” është kontrata, marrëveshja ose rregullat që përcaktojnë përfitimet e pensionit, si dhe kriteret dhe dhënien e këtyre përfitimeve.

41. “Përfitimet e pensionit” janë përfitimet që paguhet me arritjen e moshës së pensionit ose në pritje të arritjes së saj. Kur parashikohet në kontratë, marrëveshje ose në rregullat e skemës së pensionit, përfitimet e pensionit mund të përfshijnë edhe përfitime plotësuese.

Për qëllime të sigurimit të të ardhurave dhe sigurisë financiare gjatë pensionit, përfitimet e pensionit mund të jepen në formën e pagesave periodike të përjetshme, pagesave periodike për një periudhë të caktuar, pagesës së një shume të vetme, ose një kombinim të këtyre formave.

42. “Skemë me kontribute të përcaktuara” është skema e pensionit në të cilën përfitimet e pensionit përcaktohen në bazë të kontributeve të paguara dhe të ardhurave ose kthimeve të realizuara nga investimi i këtyre kontributeve.

43. “Skemë me përfitime të përcaktuara” është skema e pensionit në të cilën niveli i përfitimeve të pensionit përcaktohet paraprakisht, duke u bazuar në një ose më shumë faktorë, përfshirë pagën, periudhën e punësimit ose vjetërsinë në punë, si dhe kriteret e tjera të përcaktuara në rregullat e skemës. Në rastin e veprimtarive ndërkufitare, krijimi dhe administrimi i një skeme me përfitime të përcaktuara lejohet vetëm nëse kjo parashikohet nga legjislacioni i shtetit anëtar pritës.

44. “Shtet anëtar pritës” është shteti, i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, legjislacioni i të cilit në fushën e mbrojtjes sociale dhe të marrëdhënieve të punës, zbatohet për skemat e pensionit profesional dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet sponsorit dhe anëtarëve ose përfituesve të skemës.

45. “Shtet anëtar i origjinës” është shteti në të cilin institucioni i pensionit profesional (IORP) është regjistruar ose autorizuar dhe në të cilin ndodhet administrata e tij qendrore.

46. “Veçim i aktiveve dhe detyrimeve (*ring-fencing*)” është ndarja juridike dhe operacionale e aktiveve dhe detyrimeve, me qëllim që ato të përdoren ekskluzivisht për një

skemë pensioni të caktuar dhe të mbrohen nga pretendimet që nuk lidhen me atë skemë pensioni.

47. “Kërkesa të aftësisë dhe përshtatshmërisë” janë kërkesat që sigurojnë se personat që drejtojnë institucionin ose ushtrojnë funksione kryesore kanë integritet dhe reputacion të mirë, si dhe zotërojnë kualifikimet profesionale, njohuritë dhe përvojën e nevojshme për ushtrimin e detyrave të tyre.

48. “Autoriteti Europian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA)” është Autoriteti Europian i Mbikëqyrjes, i krijuar me Rregulloren (BE) nr. 1094/2010 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 24 nëntor 2010.

49. “Institucion transferues” është institucioni i pensionit profesional (IORP) që transferon, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet, rezervat teknike, të drejtat dhe detyrimet e tjera, si dhe aktivet përkatëse ose ekuivalentin e tyre në mjete monetare, tek një institucion i pensionit profesional (IORP) i regjistruar ose i autorizuar në një shtet tjetër anëtar.

50. “Institucion marrës” është institucioni i pensionit profesional (IORP) që merr, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet, rezervat teknike, të drejtat dhe detyrimet e tjera, si dhe aktivet përkatëse ose ekuivalentin e tyre në mjete monetare, nga një institucion i pensionit profesional (IORP) i regjistruar ose i autorizuar në një shtet tjetër anëtar.

51. “Mjet i qëndrueshëm komunikimi” është çdo mjet ose instrument që i mundëson anëtarit ose përfituesit të ruajë informacionin e adresuar personalisht atij, në një formë të aksesueshme për përdorim të mëvonshëm, për një periudhë kohore të përshtatshme, si dhe që garanton riprodhimin e saktë dhe të pandryshuar të informacionit të ruajtur.

52. “Rrezik biometrik” janë rreziqet që lidhen me vdekshmërinë, paaftësinë për punë dhe jetëgjatësinë.

53. “Punëmarrës i dërguar” është personi që dërgohet për të punuar në një shtet tjetër anëtar dhe që, në përputhje me dispozitat e Titullit II të Rregullores (KEE) nr. 1408/71, vazhdon t’i nënshtrohet legjislacionit të shtetit anëtar të origjinës.

54. “Të drejta pensioni të fituara” janë të drejtat për përfitime pensioni që fitohen pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në rregullat e skemës të pensionit suplementar dhe, kur parashikohet, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

55. “Përfitues i shtyrë” është ish-anëtari aktiv i një skeme pensioni suplementar, i cili ka fituar të drejta pensioni në këtë skemë, por nuk përfiton ende pension ose përfitime pensioni prej saj.

56. “Të drejta pensioni pasive” janë të drejta pensioni të fituara, që mbeten në skemën suplementare të pensionit në të cilën janë krijuar ose akumuluar dhe mbahen nga një përfitues i shtyrë. ”

#### **Neni 4**

**Neni 3, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:**

1. Në pikën 1, shkronja “a”, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

"a) shoqëritë administruese të licencuara ose shoqëritë e sigurimit të jetës të autorizuara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;"

2. Në pikën 1, shkronja “b”, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“b) shoqëritë administruese ose institucionet e pensionit profesional të një shteti tjetër anëtar, të cilat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, njihen nga Autoriteti për ushtrimin e veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit privat me pjesëmarrje të mbyllur në Republikën e Shqipërisë.”

3. Pas pikës 2, shtohen pikat 3 dhe 4, me përmbajtje si vijon:

“3. Ushtrimi i veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit privat nga një shoqëri e sigurimit të jetës lejohet vetëm nëse aktivet dhe detyrimet që lidhen me këtë veprimtari janë të veçuara (*ring-fencing*) nga aktivet dhe detyrimet e tjera të shoqërisë. Aktivet dhe detyrimet e veçuara përdoren ekskluzivisht për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga përfitimet e pensionit dhe veprimtaritë e lidhura drejtpërdrejt me to dhe nuk mund të transferohen ose të përdoren për qëllime që lidhen me veprimtari të tjera të shoqërisë së sigurimit të jetës.

4. Institucionet e pensionit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, sigurojnë, kur është e zbatueshme, shpërndarjen e drejtë të rreziqeve dhe përfitimeve ndërmjet brezave të ndryshëm të anëtarëve dhe përfituesve.”

## **Neni 5**

**Pas nenit 3, shtohet neni 3/1, me përmbajtje si më poshtë:**

“Neni 3/1

**Ushtrimi i veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit privat nga shoqëritë e sigurimit të jetës**

1. Shoqëritë e sigurimit të jetës, të licencuara për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit të jetës në Republikën e Shqipërisë, mund, pas marrjes së miratimit nga Autoriteti, të ushtrorjnë veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat, të krijojnë, administrojnë fonde të pensionit privat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me legjislacionin në fuqi për sigurimin dhe risigurimin.

2. Shoqëritë e sigurimit të jetës që ushtrorjnë veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat duhet:

- a) të mbajnë të veçuara aktivet dhe detyrimet që lidhen me këtë veprimtari nga aktivet dhe detyrimet e veprimtarive të tjera të sigurimit;
- b) të organizojnë, administrojnë dhe kontabilizojnë këtë veprimtari në mënyrë të veçantë dhe të pavarur nga veprimtaritë e tjera të ushtruara prej tyre;
- c) të mos transferojnë aktive ose detyrime ndërmjet veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit privat dhe veprimtarive të tjera të sigurimit.

3. Dispozitat e këtij ligji që rregullojnë qeverisjen, sistemin e kontrollit të brendshëm, administrimin e rrezikut, politikën e investimeve, informimin e anëtarëve dhe përfituesve, raportimin dhe mbikëqyrjen zbatohen, sipas rastit, edhe ndaj veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit privat të ushtruar nga shoqëritë e sigurimit të jetës.

4. Autoriteti miraton rregulla më të detajuara për kushtet dhe procedurat për ushtrimin e veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit privat nga shoqëritë e sigurimit të jetës, si dhe për kërkesat e detajuara lidhur me veçimin e aktiveve dhe detyrimeve, raportimin, mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e anëtarëve dhe përfituesve.

5. Ushtrimi i veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit privat nga shoqëritë e sigurimit të jetës nuk cenon zbatimin e legjislacionit në fuqi për sigurimin dhe risigurimin.”

## **Neni 6**

**Në nenin 7, bëhën ndryshimet dhe shtesat me përmbajtje si më poshtë:**

1. Pika 1, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“1. Autoriteti mban regjistrin e shoqërive administruese, fondeve të pensionit privat, institucioneve të pensionit (IORP), depozitarëve dhe çdo subjekti të licencuar/autorizuar/regjistruar/njohur, sipas këtij ligji. Regjistri publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit dhe vihet në dispozicion të publikut.”

2. Në pikën 2, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me përmbajtje si vijon: “ç” Për subjektet që administrojnë fonde të pensionit privat dhe zhvillojnë veprimtari ndërkufitare, regjistri përmban edhe informacion mbi shtetet anëtare në të cilat ushtrohet kjo veprimtari.”

3. Pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje si vijon:

“3. Autoriteti i komunikon EIOPA-s informacionin e regjistrit për publikim në faqen e saj zyrtare të internetit.”

Pika 4, rinumërohet si pika 5.

## **Neni 7**

**Në nenin 8, bëhën shtesat me përmbajtje si më poshtë :**

1. Pas pikës 1, shtohen pikat 1/1,1/2 dhe 1/3, me përmbajtje si vijon:

“1/1. Shoqëria administruese e licencuar për administrimin e fondeve të pensionit privat, sipas këtij ligji, ushtron veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat dhe veprimtaritë që lidhen drejtpërdrejt me të. Përfitime shtesë mund të ofrohen vetëm nëpërmjet një kontrate sigurimi të lidhur me një shoqëri të sigurimit të jetës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1/2. Shoqëria administruese mund të ushtrojë edhe veprimtarinë e administrimit të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, fondeve të investimeve alternative, menaxhimit individual të portofolit, me kusht që:

- a) të jetë e licencuar ose e autorizuar nga Autoriteti për ushtrimin e secilës veprimtari përkatëse;
- b) veprimtaritë të organizohen dhe të administrohen në mënyrë të veçantë;
- c) aktivet, detyrimet, regjistrat kontabël, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe proceset e administrimit të rrezikut që lidhen me veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat të mbahen të ndara nga ato që lidhen me veprimtaritë e tjera;

ç) të sigurohet identifikimi, parandalimi, administrimi monitorimi dhe shmangia konfliktit të interesit, si dhe mbrojtja e interesave të anëtarëve dhe përfituesve të fondit të pensionit.

1/3. Autoriteti miraton me rregullore kërkesat e detajuara për ndarjen organizative, funksionale, operacionale dhe kontabël të veprimtarive të parashikuara në pikën 1/2 të këtij neni.”

2. Pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me përmbajtje si vijon:

“2/1. Autoriteti mbikëqyr respektimin e kërkesave të parashikuara në këtë nen dhe garanton që shoqëritë administruese të licencuara të ushtrjnë vetëm veprimtaritë e lejuara sipas këtij ligji.”

## **Neni 8**

**Pas nenit 8, shtohet neni 8/1, me përmbajtje si më poshtë:**

### **“Neni 8/1 Kërkesat operacionale**

1. Subjektet e licencuara për administrimin e fondeve të pensionit privat, në përputhje me këtë ligj, duhet të plotësojnë këto kërkesa:

- a) të kenë miratuar dhe të zbatojnë rregulla të qarta për organizimin, funksionimin dhe administrimin e çdo skeme pensioni;
- b) kur sponsori garanton përfitimet e pensionit, të sigurojnë financimin e rregullt dhe të mjaftueshëm të detyrimeve që rrjedhin nga skema e pensionit.

2. Në përputhje me parimin e subsidiaritetit dhe duke marrë në konsideratë nivelin e mbrojtjes që sigurohet nga skemat e sigurimeve shoqërore, skema e pensionit mund të parashikojë përfitime shtesë, përfshirë mbulimin e rreziqeve të jetëgjatësisë dhe paaftësisë, mbrojtjen e personave në ngarkim dhe të të mbijetuarve, si dhe garantimin e kthimit të kontributeve.

Përfitimet e parashikuara në këtë pikë ofrohen në përputhje me rregullat e skemës së pensionit dhe me marrëveshjen ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësve ose përfaqësuesve të tyre, sipas rastit.”

## **Neni 9**

**Në nenin 10, pika 1, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:**

“1. Shoqëria administruese mban në çdo kohë kapital të mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga veprimtaria e saj, i cili në çdo rast nuk mund të jetë më pak se vlera ekuivalente në lekë e shumës 125,000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) euro.”

## **Neni 10**

**Në nenin 15, bëhen shtesa dhe ndryshime me përmbajtje si më poshtë:**

1. Pika 1, ndryshohet me përmbajtje si vijon :

“1. Çdo person, i cili është ose do të jetë aksionar, administrator, anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës, person kyç ose person që mban funksione kryesore në një shoqëri administruese, si dhe ku është e zbatueshme, çdo person ose subjekt tek i cili i është deleguar një funksion kryesor në përputhje me këtë ligj, duhet të jetë i aftë dhe i përshtatshëm për të mbajtur pozicionin e caktuar.”

2. në pikën 2, shkronja “b” pas nënpikës “ii” shtohen nënpikat “iii”, “iv” dhe “v”, me përmbajtje si vijon:

“iii. personat të cilët mbajnë pozicione drejtuese duhet të kenë njohuri, kualifikime dhe përvojë, të cilat, të marra së bashku, janë të përshtatshme për të mundur administrimin e shëndoshë dhe të kujdesshëm;

iv. personat që ushtrojnë funksionin aktuarial ose funksionin e auditit të brendshëm duhet të kenë kualifikime profesionale, njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për ushtrimin e duhur të funksioneve të tyre;

v. personat që ushtrojnë funksione të tjera kryesore duhet të kenë kualifikime, njohuri dhe përvojë të mjaftueshme për ushtrimin e duhur të këtyre funksioneve.”

3. Pas pikës 2, shtohen pikat 2/1, 2/2, 2/3 dhe 2/4, me përmbajtje si vijon:

“2/1. Në rastin e aplikantëve për administrator, anëtar të këshillit të administrimit/mbikëqyrës apo funksionarë kryesorë, aksionarëve me origjinë nga një shtet tjetër anëtar, dokumentacioni që vërteton reputacionin e mirë, mosekzistencën e rasteve të mëparshme të falimentimit, ose të dyja, përfshin ekstraktin nga regjistri gjyqësor i atij shteti anëtar ose, në mungesë të tij, një dokument të barasvlershëm të lëshuar nga autoriteti përgjegjës gjyqësor ose administrativ, i cili vërteton përmbushjen e këtyre kërkesave.

2/2. Në rast se asnjë autoritet përgjegjës gjyqësor ose administrativ, në shtetin anëtar shtetësinë e të cilit mban personi në fjalë ose në shtetin anëtar të origjinës, nuk lëshon dokumentin e barasvlershëm, personi në fjalë mund ta zëvendësojë atë me një deklaratë nën betim. Në shtetet anëtare të origjinës ku deklarata nën betim nuk parashikohet nga legjislati i përkatës, aplikantët me origjinë nga një shtet tjetër anëtar mund të paraqesin një deklaratë solemne të dhënë përpara një autoriteti përgjegjës gjyqësor ose administrativ të shtetit anëtar të origjinës ose të shtetit anëtar shtetësinë e të cilit mbajnë, ose përpara një noteri në një nga këto shtete anëtare. Autoriteti përgjegjës noteri lëshon certifikatën përkatëse që vërteton autenticitetin e deklaratës nën betim ose të deklaratës solemne.

2/3. Dokumentacioni provues lidhur me mosekzistencën e rasteve të mëparshme të falimentimit mund të paraqitet edhe në formën e një vetëdeklarimi të dhënë nga aplikanti, shtetas i një shteti tjetër anëtar, përpara një organi përgjegjës të atij shteti anëtar.

2/4. Dokumentet e përmendura në pikat 2/1, 2/2 dhe 2/3 paraqiten brenda tre (3) muajve nga data e lëshimit të tyre.”

4. Pika 3, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“3. Për qëllime të verifikimit të pajtueshmërisë me kriteret e parashikuara në këtë nen, Autoriteti njeh dhe pranon kualifikimet profesionale ekuivalente, certifikatat dhe dokumentet e tjera që vërtetojnë kompetencën profesionale, të lëshuara nga autoritetet kompetente në shtetet anëtare të Bashkimit Europian.

5. Pika 6, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“6. Autoriteti miraton me rregullore kërkesa të mëtejshme për aftësinë dhe përshtatshmërinë, sipas pikës 2 të këtij neni, përfshirë kriteret për njohjen dhe pranimin e dokumenteve të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare, për qëllime të vlerësimit të aftësisë dhe përshtatshmërisë së personave të përcaktuar në këtë nen.”

### **Neni 11**

Pas nenit 15, shtohet neni 15/1, me përmbajtje si më poshtë:

#### **“Neni 15/1**

#### **Emërimi i administraorit të investimeve nga shtetet anëtare të BE-së**

1. Shoqëria administruese mund t’i delegojë administrimin e aktiveve dhe investimeve të fondit të pensionit një menaxheri investimesh të vendosur në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian, i autorizuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie në përputhje me legjislacionin përkaktës të shtetit anëtar që rregullon sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, fondet alternative të investimit, veprimtaritë e sigurimit dhe risigurimit, institucionet e kreditit, tregjet e instrumenteve financiare, dhe institucionet e pensionit profesional Këta mund të emërohen për ofrimin e shërbimeve të administrimit të portofolit pa qenë i nevojshëm autorizim shtesë në Republikën e Shqipërisë.

2. Emërimi sipas pikës 1 të këtij neni nuk i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të nevojshme për garantimin e përputhshmërisë me këtë ligj dhe mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe përfituesve.

3. Shoqëria administruese siguron që administratori i aktiveve dhe investimeve është i autorizuar dhe i mbikëqyrur nga autoriteti përgjegjës i shtetit të origjinës, respekton kërkesat profesionale dhe të sjelljes së biznesit dhe vepron në përputhje me politikën e investimit dhe profilin e rrezikut të fondit të pensionit.

4. Autoriteti miraton rregulla më të detajuara lidhur me kërkesat për emërimin nga shoqëritë administruese të administratorëve të aktiveve dhe investimeve të vendosur në një shtet anëtar të Bashkimit Evropian.”

### **Neni 12**

Në nenin 16, bëhen ndryshimet dhe shtesa me përmbajtje si më poshtë :

1. Pikat 1 dhe 2, ndryshohen me përmbajtje si vijon:

“1. Shoqëria administruese administrohet nga dy administratorë. Përjashtimisht nga ky rregull, Autoriteti mund të lejojë, me vendim të arsyetuar dhe në përputhje me rregullat dhe kriteret e miratuara me rregullore, që shoqëria administruese të administrohet nga vetëm një person, kur kjo justifikohet nga madhësia, natyra, shkalla dhe kompleksiteti i veprimtarisë së shoqërisë dhe nuk cenon interesat e anëtarëve të fondit dhe përfituesve.

2. Administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë administruese duhet të gëzojnë reputacion të mirë, të kenë kualifikimet profesionale të kërkuara dhe përvojë të mjaftueshme, në mënyrë që të sigurojnë një administrim/mbikëqyrje të shëndoshë, të kujdesshëm dhe një sistem efektiv qeverisje të shoqërisë administruese .”

2. Pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5, me përmbajtje si vijon:

“4. Sistemi i qeverisjes i referuar në pikën 2 të këtij neni duhet të jetë proporcional në raport me madhësinë, natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarive të fondeve nën administrim.

5. Sistemi i qeverisjes duhet të përfshijë integrimin e faktorëve mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes në procesin e vendimmarrjes për investimet dhe i nënshtrohet rishikimit të brendshëm periodik.”

### **Neni 13**

Në nenin 17, pika 1 ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“1. Një person mund të emërohet administrator, anëtar i këshillit të administrimit/mbikëqyrës i shoqërisë administruese dhe të ushtrojë funksione kryesore në të vetëm me miratim të Autoritetit.”

### **Neni 14**

Në nenin 19, bëhen ndryshimet i me përmbajtje si më poshtë:

1. Titulli i nenit ndryshohet si vijon:

“Funksionet kryesore”

2. Pikat 1 dhe 2, ndryshohen me përmbajtje si vijon:

“1. Në shoqërinë administruese do të konsiderohen persona që mbajnë funksione kryesore, si më poshtë:

- a) drejtuesi i njësisë së administrimit të aktive/investimeve;
- b) drejtuesi i njësisë së administrimit të rrezikut;
- c) drejtuesi i njësisë së përputhshmërisë;
- ç) drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm;
- d) funksioni aktuarial, kur është i zbatueshëm.

2. Procedura për miratimin, humbjen e vlefshmërisë së miratimit, riemërimin ose revokimin e miratimit të personave që mbajnë funksione kryesore është e njëjtë me procedurën përkatëse për administratorin, anëtarin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, të parashikuar në nenet 17 dhe 18 të këtij ligji.”

3. Pika 4, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“4. Është përgjegjësi e këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë administruese që të sigurojë që personat, që mbajnë funksione kryesore, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, përmbushin kriteret e aftësisë dhe përshtatshmërisë, të parashikuara në nenin 15, të këtij ligji.”

### **Neni 15**

Pas nenit 19, shtohet neni 19/1, me përmbajtje si më poshtë:

#### **“Neni 19/1**

#### **Detyrimet e personave që mbajnë funksione kryesore**

1. Personi që ushtron një funksion kryesor njofton menjëherë Autoritetin kur organi drejtues ose këshilli i administrimit/mbikëqyrës i shoqërisë administruese nuk merr masat korrigjuese të nevojshme dhe në kohë, në rastet e parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni.

2. Detyrimi i parashikuar në pikën 1 të këtij neni lind kur personi që ushtron funksion kryesor identifikon një rrezik të rëndësishëm që shoqëria administruese të mos përmbushë një kërkesë ligjore ose rregullore me rëndësi materiale, e raporton këtë rrezik pranë organit drejtues ose këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe vlerëson se ai mund të cenojë në mënyrë të konsiderueshme interesat e anëtarëve ose përfituesve.

3. Detyrimi i parashikuar në pikën 1, të këtij neni lind gjithashtu kur personi që ushtron funksion kryesor identifikon një shkelje materiale të legjislacionit të zbatueshëm në fushën e përgjegjësisë së tij, e raporton atë pranë organit drejtues ose këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe ky i fundit nuk merr masat e nevojshme korrigjuese brenda një afati të arsyeshëm.

4. Një person ose njësi organizative mund të kryejë më shumë se një funksion kryesor, me përjashtim të funksionit të administrimit të rrezikut dhe auditit të brendshëm, i cili duhet të ushtrohet në mënyrë të pavarur nga funksionet e tjera kryesore.”

### **Neni 16**

Neni 20, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

#### **“Neni 20**

#### **Shoqëritë administruese që kryejnë veprimtari në një shtet anëtar**

1. Shoqëria administruese e licencuar nga Autoriteti për administrimin e fondeve të pensionit privat mund, , të administrojë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një dege një skemë pensioni në një shtet anëtar tjetër për llogari të një sponsori të vendosur në atë shtet anëtar, vetëm pasi të jetë miratuar nga Autoriteti, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Shoqëria administruese që synon të ushtrojë veprimtari ndërkufitare në përputhje me pikën 1, të këtij neni, njofton paraprakisht Autoritetin.

3. Njoftimi i parashikuar në pikën 2, të këtij neni përmban të paktën:

a) emrin e shtetit anëtar pritës;

b) emrin dhe zyrën qendrore të sponsorit;

c) karakteristikat kryesore të skemës së pensionit që do të administrojë për sponsorin.

4. Autoriteti, brenda tre muajve nga marrja e njoftimit të plotë, ia përcjell atë autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar pritës dhe njofton shoqërinë administruese.

5. Autoriteti mund të refuzojë përcjelljen e njoftimit te autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar pritës nëse vlerëson se:

- a) shoqëria administruese nuk disponon strukturën organizative, burimet njerëzore ose kapacitetet teknike të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë ndërkufitare;
- b) gjendja financiare e shoqërisë administruese nuk është e përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë së planifikuar;
- c) reputacioni i shoqërisë, kualifikimet profesionale ose përvoja e personave që drejtojnë dhe mbajnë funksione kryesore në shoqërinë administruese nuk janë të përshtatshme për ushtrimin e veprimtarisë ndërkufitare.

6. Në rastet e parashikuara në pikën 5 të këtij neni, Autoriteti, brenda tre muajve nga marrja e njoftimit të plotë, merr vendim të arsyetuar për refuzimin e dhe ia komunikon atë shoqërisë administruese.”

### **Neni 17**

Pas nenit 20, shtohen nenet 20/1 dhe 20/2, me përmbajtje si më poshtë:

#### **“Neni 20/1**

#### **Procedurat e njoftimit për ushtrimin e veprimtarisë ndërkufitare**

1. Shoqëria administruese që administron një skemë pensioni në një shtet anëtar pritës respekton dispozitat e legjislacionit të atij shteti në lidhje me detyrimin për informimin e anëtarëve dhe përfituesve të skemës së pensionit.

2. Brenda 6 javëve nga marrja e njoftimit të parashikuar në nenin 20, të këtij ligji, përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë ndërkufitare, autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar pritës i komunikon Autoritetit, legjislacionin e punës dhe të mbrojtjes sociale të zbatueshme për skemën e pensionit.

3. Autoriteti, menjëherë pas marrjes së informacionit të parashikuar në pikën 2, të këtij neni, ia komunikon atë shoqërisë administruese.

4. Shoqëria administruese mund të fillojë administrimin e skemës së pensionit në shtetin anëtar pritës pas marrjes së njoftimit sipas pikës 3, të këtij neni ose, në mungesë të tij, pas përfundimit të afatit 6-javor të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni.

5. Autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar pritës informon Autoritetin për çdo ndryshim të rëndësishëm në legjislacionin e punës dhe të mbrojtjes shoqërore të zbatueshëm për skemën e pensionit, që mund të ndikojë në ushtrimin e veprimtarisë ndërkufitare.

6. Autoriteti, menjëherë pas marrjes së njoftimit të parashikuar në pikën 5, të këtij neni, informon shoqërinë administruese për ndryshimet përkatëse.

### **Neni 20/2**

#### **Ushtrimi i veprimtarisë në Republikën e Shqipërisë nga shoqëritë e huaja**

1. Shoqëria administruese ose institucioni i pensionit profesional (IORP), i autorizuar në një shtet anëtar, mund të administrojë një fond pensioni privat me pjesëmarrje të mbyllur për një sponsor të vendosur në Republikën e Shqipërisë, pa kërkuar miratim nga Autoriteti, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Shoqëria administruese ose institucioni i pensionit profesional (IORP) i referuar në pikën 1 të këtij neni i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji që rregullojnë informimin e anëtarëve dhe përfituesve.

3. Autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës njofton Autoritetin për qëllimin e shoqërisë administruese ose të institucionit të pensioni profesional (IORP), të autorizuar në shtetin anëtar, për të administruar një fond pensioni privat me pjesëmarrje të mbyllur për një sponsor në Republikën e Shqipërisë, përveç rastit kur vlerëson se subjekti nuk disponon strukturën organizative, burimet njerëzore, kapacitetet teknike ose gjendjen financiare të nevojshme për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

4. Autoriteti, brenda 6 javëve nga marrja e njoftimit të parashikuar në pikën 3 të këtij neni, i komunikon autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës dispozitat e legjislacionit shqiptar të punës dhe mbrojtjes shoqërore të zbatueshme për skemën e pensionit, si dhe dispozitat e këtij ligji që lidhen me informimin e anëtarëve dhe përfituesve.

5. Shoqëria administruese ose institucioni i pensionit profesional (IORP) që administron një fond pensioni privat me pjesëmarrje të mbyllur, sponsori i të cilit është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, u siguron anëtarëve dhe përfituesve informacionin e kërkuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

6. Autoriteti njofton autoritetin përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës për çdo ndryshim të rëndësishëm në legjislacionin ose aktet nënligjore të referuara në pikën 4 të këtij neni, i cili mund të ndikojë në administrimin e fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të mbyllur ose në ushtrimin e veprimtarisë ndërkufitare.”

## **Neni 18**

Neni 21, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

### **"Neni 21 Transferimet ndërkufitare**

1. Shoqëria administruese e licencuar nga Autoriteti për administrimin e fondit me pjesëmarrje të mbyllur (shoqëria transferuese) ka të drejtën, tërësisht ose pjesërisht, të transferojë detyrimet, provigjionet teknike dhe të drejtat e tjera dhe detyrimet që rrjedhin nga skemat e pensionit të anëtarëve dhe përfituesve të fondit, si dhe aktivet e lidhura ose ekuivalentin monetar të tyre, te një shoqëri administruese të fondeve të pensionit në një shtet anëtar tjetër (shoqëria pritëse).

2. Përpara kryerjes së transferimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, shoqëria pritëse duhet të pajiset me miratimin e autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës. Autoriteti përgjegjës në shtetin anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse merr vendim për kërkesën e transferimit brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës së plotë dhe të rregullt, duke njoftuar shoqërinë pritëse për vendimin e marrë brenda të njëjtit afat.

3. Përpara paraqitjes së kërkesës për miratim pranë autoritetit përgjegjës, sipas pikës 1, të këtij neni, shoqëria pritëse siguron pëlqimin paraprak të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të fondit të mbyllur dhe përfituesve të pensionit, skema e pensionit ose aktivet e të cilëve janë objekt i transferimit, si dhe pëlqimin e sponsorit për transferimin e propozuar.

4. Shoqëria transferuese, përpara paraqitjes së kërkesës për miratimin, informon në kohë anëtarët e fondit me pjesëmarrje të mbyllur, dhe përfituesve të pensionit, skema e pensionit dhe/ose aktivet e të cilëve janë objekt i transferimit, për kushtet, procedurat dhe rrethanat e transferimit, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të vlerësojnë pasojat që transferimi mund të ketë mbi të drejtat dhe aktivet e tyre.

5. Kostot e transferimit nuk përballohen nga anëtarët dhe përfituesit e skemës së pensionit të shoqërisë pritëse. Në rast transferimi të pjesshëm, këto kosto nuk përballohen as nga anëtarët dhe përfituesit e mbetur të fondit të mbyllur, skema e pensionit dhe/ose aktivet e të cilëve nuk janë objekt i transferimit.

6. Kërkesa për miratimin e transferimit, përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:
- a) marrëveshjen me shkrim ndërmjet shoqërisë transferuese dhe shoqërisë pritëse, ku përcaktohen kushtet e transferimit;
  - b) përshkrimin e karakteristikave kryesore të skemës së pensionit;
  - c) përshkrimin e të drejtave dhe detyrimeve që transferohen, si dhe të aktiveve përkatëse ose të vlerës së tyre monetare;
  - ç) emrin dhe selinë e shoqërisë transferuese dhe të shoqërisë pritëse, si dhe shtetin anëtar në të cilin ato janë regjistruar ose autorizuar për të ushtruar veprimtarinë;
  - d) emrin dhe selinë e sponsorit;
  - dh) dokumentacionin që provon marrjen e pëlqimit paraprak sipas përcaktimeve të këtij ligji;
  - e) shtetin anëtar, legjislacioni social dhe i punës i të cilit zbatohet për skemën e pensionit, kur është e zbatueshme.

7. Autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse vlerëson nëse:
- a) kërkesa përmban të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5 të këtij neni.
  - b) sistemi i qeverisjes, gjendja financiare e shoqërisë pritëse, si dhe përmbushja e kërkesave që lidhen me përshtatshmërinë, reputacionin, kualifikimet profesionale dhe përvojën e personave që drejtojnë shoqërinë pritëse janë në përputhje me transferimin e propozuar;
  - c) interesat afatgjata të anëtarëve dhe përfituesve të skemës së pensionit të shoqërisë pritëse, si dhe të pjesës së transferuar të skemës, mbrohen në mënyrë të përshtatshme gjatë dhe pas transferimit;
  - ç) provigjonet teknike të shoqërisë pritëse janë plotësisht të mbuluara në datën e transferimit, kur kjo është e zbatueshme;
  - d) aktivet që transferohen janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbuluar detyrimet, provigjonet teknike dhe të drejtat e detyrimeve të tjera që transferohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse. Autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse ia përcjell Autoritetit kërkesën pa vonesë pas marrjes së saj.

8. Autoriteti, pas marrjes së kërkesës neni nga autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse, vlerëson nëse:

- a) në rastin e transferimit të pjesshëm të detyrimeve të skemës së pensionit, të provigjoneve teknike dhe të të drejtave e detyrimeve të tjera, si dhe të aktiveve përkatëse ose të vlerës së tyre monetare, interesat afatgjata të anëtarëve dhe përfituesve të pensionit që mbeten në skemë mbrohen në mënyrë të përshtatshme;
- b) të drejtat individuale të anëtarëve dhe përfituesve të pensionit janë të paktën të njëjta pas transferimit;
- c) aktivet e skemës së pensionit që transferohen janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbuluar detyrimet, provigjonet teknike dhe të drejtat e detyrimeve të tjera që transferohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti, brenda 8 javëve nga marrja e kërkesës sipas pikës 3, të këtij neni, njofton autoritetin përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse për rezultatet e vlerësimit të kryer

sipas pikës 8 të këtij neni, me qëllim mundësimin e marrjes së vendimit për miratimin e transferimit.

9. Nëse autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse vendos të refuzojë kërkesën për miratimin e transferimit ndërkufitar, ai merr një vendim të arsyetuar, i cili përmban edhe informacion mbi mjetet juridike të disponueshme, brenda 3 (tre) muajve nga data e marrjes së kërkesës së plotë dhe të rregullt.

Kundër vendimit për refuzimin e kërkesës, ose në rast se autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse nuk merr vendim brenda afatit të përcaktuar, shoqëria pritëse ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente të atij shteti anëtar.

10. Autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse njofton Autoritetin për vendimin lidhur me miratimin ose refuzimin e kërkesës për autorizimin e transferimit ndërkufitar, brenda 2 javëve nga data e miratimit të vendimit. Në rast se transferimi sjell ushtrimin ndërkufitar të veprimtarisë, Autoriteti, brenda 4 javëve nga marrja e vendimit të autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse, i komunikon atij dispozitat e legjislacionit të mbrojtjes shoqërore dhe të punës të shtetit pritës që lidhen me skemën e pensionit, si dhe kërkesat në lidhje me detyrimin për informimin e anëtarëve të skemës së pensionit.

11. Autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse, brenda 1 jave nga marrja e informacionit të përcaktuar në pikën 10 të këtij neni, ia përcjell atë shoqërisë pritëse.

12. Shoqëria pritëse mund të fillojë ushtrimin e veprimtarisë pas marrjes së vendimit për autorizimin e transferimit ndërkufitar, ose, në mungesë të një vendimi nga autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë pritëse, pas kalimit të një afati prej 3 muajsh nga data e paraqitjes së kërkesës së rregullt.

13. EIOPA mund të kryejë ndërmjetësim jo detyrues, në përputhje me nenin 31, pika 2, shkronja "c", të Rregullores (BE) 1094/2010, me kërkesë të një prej autoriteteve përgjegjëse ose me iniciativën e saj, në rast mosmarrëveshjeje lidhur me procedurën, veprimet apo mosveprimet, përfshirë vendimin për miratimin ose refuzimin e transferimit ndërkufitar.

14. Autoriteti ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së një institucioni pensioni nga një shtet tjetër anëtar, që administron një fond të mbyllur të një sponsori në Republikën e Shqipërisë, me dispozitat e legjislacionit të mbrojtjes shoqërore dhe të punës, që lidhen me skemat e pensionit në Republikën e Shqipërisë.

Në rast se gjatë mbikëqyrjes identifikohen parregullsi, Autoriteti njofton menjëherë autoritetin përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës, i cili, në bashkëpunim me Autoritetin, merr masat e nevojshme për të eliminuar shkeljet e dispozitave të legjislacionit të mbrojtjes shoqërore dhe të punës që lidhen me skemat e pensionit në Republikën e Shqipërisë.

15. Nëse, pavarësisht masave të marra sipas pikës 13, të këtij neni nga autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës në bashkëpunim me Autoritetin, shoqëria e pensionit nga një shtet tjetër anëtar vijon shkeljet, Autoriteti, pas njoftimit të autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës, merr masat e nevojshme për parandalimin ose sanksionimin e shkeljeve të mëtejshme dhe, kur është e nevojshme, mund t'i ndalojë shoqërisë të administrimitin e mëtejshëm të fondit të mbyllur të të njëjtit sponsor në territorin e Republikës së Shqipërisë.

16. Në rastin e parashikuar në pikën 14 të këtij neni, kur Autoriteti ndalon një shoqëri administruese e fondeve të pensionit nga një shtet tjetër anëtar të administrojë një skemë pensioni të një sponsori nga Republika e Shqipërisë, ai njofton shoqërinë e pensionit dhe EIOPA-n dhe jep arsyet të detajuara për ndalimin.

17. Kur Autoriteti merr njoftim nga autoriteti përgjegjës i shtetit anëtar të origjinës së një shoqërie që administron një fond të mbyllur në territorin e Republikës së Shqipërisë, për

tërheqjen ose revokimin e licencës së veprimtarisë së shoqërisë, tërësisht ose për veprimtari të veçanta, Autoriteti mund të marrë masa për mbrojtjen e interesave të anëtarëve të fondit, përfshirë, ndër të tjera, ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë ose ndalimin e ofrimit të skemave të pensionit në territorin e Republikës së Shqipërisë."

## **Neni 19**

Pas nenit 21 shtohen nenet 21/1 deri 21/7, me me përmbajtje si më poshtë:

### **“Neni 21/1 Fondet me përfitime të përcaktuara**

1. Shoqëria administruese mund të krijojë dhe administrojë një fond me pjesëmarrje të mbyllur me përfitime të përcaktuara vetëm për nevojat e sponsorit të një shtet tjetër anëtar, nëse krijimi i fondit të tillë lejohet sipas legjislacionit të atij shteti anëtar.

2. Plani i pensionit me përfitime të përcaktuara të fondit me pjesëmarrje të mbyllur nuk mund të ofrohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 21/2 Provigjonet teknike**

1. Me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me planin e pensionit, shoqëria administruese që administron fondin me pjesëmarrje të mbyllur me përfitime të përcaktuara si fond ndërkufitar siguron që fondi në çdo kohë:

- a) ka nivel të duhur të fondeve (rezerva teknike) që korrespondon me vlerën e detyrimeve financiare të marra që rrjedhin nga kontratat ekzistuese të anëtarësimit;
- b) ka aktive të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbuluar rezervat teknike të referuara në shkronjën 'a' të kësaj pike, duke marrë parasysh të gjitha fondet me pjesëmarrje të mbyllur që administron.

2. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit nuk mban përgjegjësi për mungesën e provigjoneve teknike. Nëse kjo mungesë vjen si pasojë e pagesave të pamjaftueshme të kontributeve nga kontribuesi (punëdhënësi).

### **Neni 21/3 Llogaritja e provigjoneve teknike**

1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit është e detyruar të llogarisë çdo vit provigjonet teknike të fondit me pjesëmarrje të mbyllur me përfitime të përcaktuara. Llogaritja e provigjoneve teknike përgatitet dhe certifikohet nga aktuar i certifikuar.

2. Llogaritja e provigjoneve minimale teknike bazohet në vlerësime aktuariale të besueshme, duke marrë në konsideratë të gjitha detyrimet e supozuara të pagesave të skemës së pensionit.

Provigjonet teknike duhet të jenë të mjaftueshme për të mbuluar pagesat të pensioneve të ardhshme dhe të pensioneve aktuale, si dhe të pasqyrojnë detyrimet që rrjedhin nga të drejtat e pensionit të fituara. Gjatë përzgjedhjes së supozimeve ekonomike dhe aktuariale të vlerësimit, veprohet në mënyrë të kujdesshme, duke marrë në konsideratë një marzh të përshtatshëm të devijimeve të pafavorshme.

3. Normat e skontimit për llogaritjen e vlerës së detyrimeve zgjidhen në mënyrë të kujdesshme dhe duke marrë në konsideratë:

a) normat e kthimit të tregut të obligacioneve qeveritare me afat të ngjashëm me detyrimet, duke mbajtur parasysh llogaritjet e EIOPA-s për normën afatgjatë të pritshme (Ultimate Forëard Rate), në rastet kur nuk ekzistojnë obligacione qeveritare me afat të mjaftueshëm.

4. Tabelat biometrike të përdorura për llogaritjen e provigjoneve teknike bazohen në parime prudenciale, duke marrë në konsideratë karakteristikat kryesore të anëtarëve dhe të skemave të pensionit, dhe veçanërisht ndryshimet e pritshme të rreziqeve të rëndësishme.

5. Zbatimi i metodës dhe bazës së llogaritjes së provigjoneve teknike duhet të jetë i qëndrueshëm për çdo vit ushtrimor, ndërsa devijimet mund të justifikohen vetëm në rast ndryshimesh në aspektin ligjor, demografik ose ekonomik, mbi të cilat bazohen supozimet.

6. Autoriteti përcakton kritere shtesë për llogaritjen e provigjoneve teknike të një fondi të mbyllur me përfitime të përcaktuara, i cili përdoret për qëllime ndërkufitare.

#### **Neni 21/4**

#### **Aktivitet që mbulojnë provigjonet teknike**

1. Aktivitet që mbulojnë provigjonet teknike duhet të investohen në mënyrë të përshtatshme me natyrën dhe kohëzgjatjen e pensioneve të ardhshme të pritura.

2. Investimet e lejuara dhe kufizimet mbi investimin e aktiveve janë subjekt i dispozitave të Kreut V të këtij ligji.

3. Përveç kufizimeve të referuara në pikën 2, aktivitet që mbulojnë provigjonet teknike i nënshtrohen kufizimeve shtesë sipas rregullave të miratuara nga Autoriteti.

#### **Neni 21/5**

#### **Financimi i provigjoneve teknike dhe planet e rimëkëmbjes**

1. Për fondet e pensionit me përfitime të përcaktuara, të cilat lejohen vetëm për skema ndërkufitare, provigjonet teknike duhet të jenë në çdo kohë plotësisht të financuara në çdo kohë. Në rast se kjo kërkesë nuk përmbushet, Autoriteti ndërhyr menjëherë dhe kërkon që fondi i pensionit me përfitime të përcaktuara, në kuadër të veprimtarisë ndërkufitare, të marrë masat e duhura, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e duhur e anëtarëve dhe përfituesve.

2. Në rast të ndërprerjes dhe/ose pamundësisë për të vazhduar veprimtarinë e një fondi të mbyllur me përfitime të përcaktuara gjatë periudhës së mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, shoqëria administruese njofton Autoritetin dhe ndërmerr procedurën për transferimin e aktiveve dhe detyrimeve të një shoqëri tjetër pensioni.

#### **Neni 21/6**

#### **Fondet e veta**

1. Në rastet kur vetë IORP-i dhe jo sponsori mbulon rrezikun e detyrimeve që lidhen me rreziqet biometrike, ose garanton një nivel të caktuar të performancës së investimeve apo një nivel të caktuar përfitimesh, kërkohet që të mbahen në mënyrë të përhershme aktive shtesë mbi provigjonet teknike. Shuma e këtyre aktiveve pasqyron llojin e rrezikut dhe strukturën e portofolit të aktiveve në lidhje me tërësinë e skemave të administruara. Këto aktive duhet të

jenë të lira nga çdo dhe të shërbejnë si për të absorbuar mospërputhjet ndërmjet shpenzimeve dhe fitimeve të pritshme dhe atyre faktike.

2. Për qëllime të llogaritjes së shumës minimale të aktiveve shtesë, zbatohen rregullat e përcaktuara në nenet 20/6, 20/7 dhe 20/8 të ligjit.

### **Neni 21/7**

#### **Niveli i kërkuar i aftësisë paguese**

1. Autoriteti kërkon që çdo IORP, i parashikuar në nenin 20/6, pika 1, i cili është i regjistruar ose i licencuar në Republikën e Shqipërisë, të disponojë në çdo kohë një nivel të përshtatshëm të aftësisë paguese për të gjithë veprimtarinë e tij, i cili është të paktën i barabartë me kërkesat rregullatore.

2. Autoriteti përcakton me rregullore detajet për nivelin e kërkuar të aftësisë paguese dhe për mënyrën e llogaritjes.”

### **Neni 20**

Në nenin 22, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, paragrafi parë. ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“1. Shoqëria administruese e fondeve të pensionit dhe shoqëria e sigurimit të jetës që ushtron veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe rregulloreve të miratuara nga Autoriteti, duhet:”

2. Pas pikës 1, shtohen pikat 2, 3, 4 dhe 5 me përmbajtje si vijon:

“2. Shoqëria administruese merr masat e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë dhe rregullsinë e ushtrimit të veprimtarisë së saj, përfshirë hartimin e planeve të emergjencës. Për këtë qëllim, ajo disponon sisteme, burime dhe procedura të përshtatshme e proporcionale, si dhe krijon dhe administron rrjetin dhe sistemet e informacionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për qëndrueshmërinë operacionale dixhitale.

3. Shoqëria administruese miraton dhe zbaton politika të shkruara për menaxhimin e rrezikut, auditimin e brendshëm, si dhe, kur është e zbatueshme, për funksionin aktuarial dhe funksionet/veprimtaritë e deleguara. Këto politika miratohen paraprakisht nga organi drejtues ose mbikëqyrës i shoqërisë administruese dhe rishikohen të paktën një herë në tre vjet, si dhe sa herë që ndodhin ndryshime të rëndësishme në sistemin ose fushën përkatëse që rregullohet nga këto politika.

4. Organi drejtues ose mbikëqyrës i shoqërisë administruese mban përgjegjësinë përfundimtare për sigurimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së saj me kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

5. Dispozitat e këtij ligji nuk cenojnë të drejtat dhe rolin e punëdhënësve, punëmarrësve ose përfaqësuesve të tyre në qeverisjen dhe administrimin e fondeve të pensionit privat, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

### **Neni 21**

Pas nenit 22, shtohet neni 22/1, me përmbajtje si më poshtë:

## **“Neni 22/1**

Zbatimi ndaj institucioneve të pensionit që operojnë skema të sigurimeve shoqërore

1. Institucionet e pensionit, të cilat ushtrojnë gjithashtu veprimtari në skema pensioni të detyrueshme të lidhura me marrëdhëniet e punës, të cilat klasifikohen si skema të sigurimeve shoqërore dhe të mbuluara nga Rregulloret (KE) nr. 883/2004 dhe nr. 987/2009, i nënshtrohen dispozitave të këtij ligji vetëm për veprimtarinë e tyre në fushën e pensioneve private vullnetare.

2. Në këto raste, aktivet dhe detyrimet përkatëse mbahen të ndara dhe nuk lejohet transferimi i tyre ndërmjet skemave të pensioneve private vullnetare dhe skemave të pensioneve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore.”

## **Neni 22**

Neni 23, bëhen ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:

Në pikën 4, pas nënpikës 'iii' shtohet nënpika 'iv' me përmbajtje si vijon:

“iv. Investimet që përfshijnë palë të lidhura kryhen mbi bazën e kushteve të tregut dhe në përputhje me parimin e tregut të lirë, duke i dhënë përparësi interesave të anëtarëve.”

## **Neni 23**

Në nenin 24, bëhet shtesame përmbajtje si më poshtë:

1. Pas pikës 2, shtohet pika 3, me përmbajtje si vijon:

”3. Shoqëria administruese duhet të ketë procedura të përshtatshme administrative dhe kontabël, si dhe sisteme efektive të kontrollit të brendshëm dhe të administrimit të rrezikut.”

## **Neni 24**

Në nenin 25, pika 1, bëhen shtesat dhe ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:

1. Pika 1, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“1. Shoqëria administruese duhet të ketë njësinë e auditit të brendshëm, me madhësi dhe kapacitet të përshtatshëm, në raport me madhësinë, natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë që ajo kryen. Funkzioni i auditit të brendshëm vlerëson përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të elementeve të tjera të sistemit të qeverisjes, duke përfshirë sipas rastit, funksionet e deleguara.”

2. Pas pikës 3, shtohet pika 4, me përmbajtje si vijon:

“4. Shoqëria administruese duhet të ngrejë një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm. Ky sistem përfshin procedura administrative dhe kontabël, një kuadër të kontrollit të brendshëm, si dhe rregullime të përshtatshme të raportimit në të gjitha nivelet e shoqërisë.”

## Neni 25

Në nenin 26, bëhen shtesat dhe ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:

1. Në pikën 3, shkronja “b”, “ç” dhe “dh” ndryshohen me përmbajtje sivejton:

“b) investimet, veçanërisht në produkte derivative, produkte të titullzuara dhe instrumente të ngjashme

:

ç) rrezikun operacional, rrezikun e tregut, rrezikun e kreditit

dh) rrezikun mjedisor, social dhe të qeverisjes, që lidhet me portofolin e investimeve dhe administrimin e tij;”

2. Në pikën 3, pas shkronjës “e” shtohet shkronja 'ë' si më poshtë:

“ë) vlerësimin e detyrimeve dhe krijimin e rezervave teknike, kur është e zbatueshme.”

3. Në pikën 7, ndryshohet si më poshtë:

“Shoqëria administruese është e detyruar të identifikojë, të monitorojë, të vlerësojë, të rishikojë dhe të përditësojë mjaftueshmërinë, gjithëpërfshirjen dhe efektivitetin e politikës dhe procedurave të administrimit të rrezikut dhe teknikave të matjes së rrezikut dhe përshtatshmërinë, auditin e brendshëm dhe, funksionet aktuariale dhe ato të deleguara, në rastet kur është e aplikueshme, në mënyrë që të eliminohen mangësitë e mundshme në strategjitë, politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut.”

## Neni 26

Pas neni 26, shtohet neni 26/1, me përmbajtje si më poshtë:

### “Neni 26/1 Funksioni aktuarial

1. Shoqëria administruese krijon funksionin aktuarial, kur fondi i pensionit mbulon rreziqe biometrike, garanton performancën e investimeve apo një nivel të caktuar përfitimesh.

2. Funksioni aktuarial, kur është i zbatueshëm:

a) koordinon dhe mbikëqyr llogaritjen e provigjoneve teknike;

b) vlerëson përshtatshmërinë e metodave, modeleve dhe supozimeve të përdorura për llogaritjen e provigjoneve teknike;

c) vlerëson mjaftueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave të përdorura për llogaritjen e provigjoneve teknike;

ç) krahason supozimet e përdorura në llogaritje me të dhënat e realizuara;

d) informon organin drejtues ose mbikëqyrës për besueshmërinë dhe përshtatshmërinë e llogaritjes së provizioneve teknike;

dh) jep mendim për politikën e pranimi dhe administrimit të rreziqeve (underwriting policy), kur është e zbatueshme;

e) kontribuon në zbatimin efektiv të sistemit të administrimit të rrezikut.

3. Shoqëria cakton të paktën një person të pavarur, i cili është përgjegjës për funksionin aktuarial.
4. Autoriteti miraton rregulla të mëtejshme për organizimin dhe funksionimin e funksionit aktuarial, përfshirë kërkesat lidhur me kualifikimet profesionale, pavarësinë dhe detyrimet e raportimit. "

## **Neni 27**

Në nenin 28, bëhen ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:

1. Pika 1, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“1. Shoqëria administruese kryen dhe dokumenton vlerësimin e saj të rrezikut në mënyrë të përshtatshme me madhësinë e saj, strukturën e brendshme organizative, si dhe madhësinë, natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteteve të saj. Vetëvlerësimi i rrezikut të shoqërisë është pjesë përbërëse e proceseve të administrimit dhe vendimmarrjes dhe merret në konsideratë në marrjen e vendimeve strategjike.”

2. Në pikën 3, shkronjat “ç” dhe “dh” ndryshohen me përmbajtje si vijon:

“ç. vlerësimin e rreziqeve për anëtarët e fondit dhe përfituesit e pensionit në lidhje me pagesën e përfitimeve nga fondi i pensionit dhe efektivitetin e masave korrigjuese, dhe kur është e aplikueshme:

- i. mekanizmat e indeksimit;
- ii. mekanizmat e reduktimit të përfitimeve, duke përfshirë masën në të cilën përfitimet e akumuluarat të pensionit mund të reduktohen, kushtet e reduktimit dhe subjektin prej të cilit mund të bëhet reduktimi;

dh) vlerësimin e rreziqeve të lidhura me faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes, si dhe vlerësimin e rreziqeve të reja, përfshirë rreziqet e lidhura me ndryshimet klimatike, përdorimin e burimeve dhe mjedisin, rreziqet sociale dhe rreziqet e lidhura me zhvlerësimin e aktiveve si rezultat i ndryshimeve rregullatore, nëse shoqëria administruese i merr parasysh këta faktorë gjatë vendimmarrjes për investime;”

2. Në pikën 3, pas shkronjës “e”, shtohet shkronja “” me përmbajtje si vijon:

“f) vlerësimin cilësor të mekanizmave që sigurojnë mbrojtjen e përfitimeve të pensionit, përfshirë, sipas rastit, garancitë, marrëveshjet, ose forma të tjera të mbështetjes financiare të ofruara nga sponsori, sigurimin ose risigurimin nga një shoqëri që është subjekt i legjislacionit në fuqi të shtetit anëtar i cili transponon direktivën 2009/138/KE, si dhe mbulimin nga një skemë e mbrojtjes së pensioneve në favor të fondit të pensionit, anëtarëve ose përfituesve të tij.”

4. Pas pikës 4, shtohen pikat 5 dhe 6, me përmbajtje si vijon:

“5. Në rastet kur është e zbatueshme, vetëvlerësimi i rrezikut duhet të përfshijë edhe një vlerësim të mekanizmave mbrojtës të drejtave të akumuluarat të pensionit, rreziqeve të lidhura me delegimin dhe ofruesve të shërbimeve të palëve të treta si dhe rrezikun e lidhur me veprimtarinë ndërkufitare.

6. Autoriteti miraton rregulla më të detajuara për vetëvlerësimin e rrezikut.”

## **Neni 28**

**Në nenin 29, bëhen shtesat dhe ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:**

1. Pika 2, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“2. Politika e shpërblimit duhet të jetë e përshtatshme për madhësinë dhe organizimin e brendshëm të shoqërisë administruese dhe madhësinë, natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktivitetit të saj. Shoqëria administruese është përgjegjëse për zbatimin e politikës së shpërblimit sipas përcaktimeve të këtij neni dhe të këtij ligji.”

2. Pas pikës 4, shtohen pikat 5 dhe 6, me përmbajtje si vijon:

"5. Kur shoqëria administruese delegon funksione ose veprimtari te palë të treta, ajo siguron që politika e shpërblimit të ofruesve të shërbimeve palë të treta të jenë në përputhje me politikën e shpërblimit të përcaktuar në nenin 29 të këtij ligji.

6. Shoqëria administruese bën publike, në faqen e saj zyrtare të internetit, informacionin përkatës në lidhje me politikën e saj të shpërblimit, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale."

## **Neni 29**

Në nenin 34 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1, 2, 3 dhe 4, ndryshohen me përmbajtje si vijon:

"1. Shoqëria administruese në kuadër të veprimtarisë së saj mund të delegojë te palë të treta, tërësisht ose pjesërisht, një ose disa funksione, përfshirë funksionet kryesore, me përjashtim të rastit kur ky delegim vështirëson mbikëqyrjen e veprimtarisë së deleguar ose veprimtarinë e shoqërisë administruese në tërësi, pengon shoqërinë administruese që të veprojë në interesin më të mirë të anëtarëve të fondeve që administrojnë, dëmton cilësinë e sistemit të qeverisjes, ose rrit rrezikun operacional. Funksione të një rëndësie të veçantë, siç është administrimi i aktiveve të fondeve dhe administrimi i rrezikut të parashikuara në këtë ligj nuk mund të delegohen.

2. Shoqëria administruese njofton menjëherë Autoritetin, për çdo delegim të funksioneve ose veprimtarive te një palë e tretë. Kur delegimi lidhet me funksionet kryesore, njoftimi i paraqitet Autoritetit përpara hyrjes në fuqi të marrëveshjes së delegimit. Shoqëria administruese njofton gjithashtu Autoritetin për çdo ndryshim ose zhvillim të rëndësishëm që lidhet me funksionet ose veprimtaritë e deleguara.

3. Delegimi i funksioneve te palë të treta mund të kryhet vetëm me miratimin e Autoritetit. Shoqëria administruese vazhdon të jetë përgjegjëse për përmbushjen e funksionit të deleguar, për mbarëvajtjen e funksioneve dhe për mbikëqyrjen e personave, të cilëve u delegohen me kontratë këto funksione, përfshirë edhe përputhshmërinë në vazhdimësi me kërkesat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 5 të këtij neni. Shoqëria

administruese e fondeve të pensionit privat garanton bashkëpunim efektiv ndërmjet saj dhe subjektit që i janë deleguar funksionet dhe garanton që mbikëqyrja efektive nga ana e Autoritetit të mos pengohet për shkak të delegimit.

4. Kontrata për delegimin e funksioneve duhet të përcaktojë qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese dhe Autoriteti, nëse e gjykon të arsyeshme, mbikëqyr veprimtarinë e të deleguarit në funksion të mbrojtjes së anëtarëve të fondit.”

2. Pas pikës 5, shtohet pika 5/1 me përmbajtje si vijon:  
“Kushtet e përmendura në pikën 5, të këtij neni konsiderohen të përmbushura nëse subjekti i deleguar është një shoqëri e cila, në kohën e lidhjes së kontratës me shoqërinë deleguese, menaxhon një fond pensioni privat.”

### **Neni 30**

Neni 35, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

"1. Çdo individ ose person juridik, grup personash të lidhur, ose persona që veprojnë bashkërisht (blerësi i synuar) i cili synon të marrë drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë apo të rrisë pjesëmarrjen në një shoqëri administruese, e cila arrin ose tejkalon pragun prej 10%, 20%, 30%, 50% ose 75% të aksioneve në kapital ose të të drejtave të votës, duhet të marrë paraprakisht miratimin e Autoritetit.

2. Blerësi i synuar që synon të marrë ose të rrisë pjesëmarrjen në shoqërinë administruese duke u bërë aksionar influencues, njofton me shkrim Autoritetin për qëllimin e tij. Kërkesa për miratimin e aksionarit influencues duhet të përmbajë:

- a) numrin dhe vlerën nominale të aksioneve që synohet të blihet;
- b) dokumentacionin e parashikuar në nenet 11 dhe 15 të këtij ligji."

### **Neni 31**

Në nenin 50, pas pikës 2, shtohet pika 3, me përmbajtje si më poshtë:

:

"3. Fondet e pensionit privat janë juridikisht të ndara nga sponsori, me qëllim mbrojtjen e aktiveve të fondit në interes të anëtarëve dhe përfituesve në rast falimentimi të sponsori."

### **Neni 32**

Në nenin 57, pika 2, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

"2. Aktivet e fondit të pensionit veçohen nga aktivet e shoqërisë administruese dhe nuk mund të jenë pjesë e procedurës së falimentimit të shoqërisë administruese, si dhe nuk mund t'i nënshtrohen ekzekutimit të detyrueshëm për detyrimet e shoqërisë administruese."

### **Neni 33**

Në nenin 62, pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtje si më poshtë:

"3/1. Përpara anëtarësimit të punëmarrësve në fondin e pensionit punëdhënësi/sponsori duhet të informojë anëtarin se si përfundimi i marrëdhënies së punës do të ndikojë në të drejtat e tyre mbi fondin e pensionit."

### **Neni 34**

Në nenin 65, pika 4, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

"4. Nëse anëtari, përkohësisht ose përgjithmonë, pushon së kontribuari në fondin e pensionit, ai mbetet anëtar në fondin e pensionit dhe ka të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë të fondit të pensionit.

Anëtari i fondit të pensionit, i cili ndërpret marrëdhënien e punës me punëdhënësin ose sponsorin, vazhdon të gëzojë të njëjtat të drejta që burojnë nga anëtarësia në fond në të njëjtën mënyrë si anëtarët e tjerë të fondit. Të drejtat e përfituara deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës konsiderohen "të drejta të fituara" dhe ruhen edhe në rastin kur anëtari transferohet ose ushtron veprimtari në një shtet tjetër anëtar."

### **Neni 35**

Në nenin 66, pika 4, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

"4. Periudha përpara se punëmarrësit t'i njihet e drejta e përfitimit të kontributeve të paguara nga punëdhënësi nuk mund të jetë më e gjatë se tre vjet."

### **Neni 36**

Në nenin 71, pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5, me përmbajtje si më poshtë:

"4. Shoqëria administruese u siguron anëtarëve të skemës që transferohen në një shtet tjetërtjetër informacion të përshtatshëm mbi të drejtat e tyre të pensionit dhe mundësitë që ofron skema. Ky informacion duhet të jetë, të paktën, i barasvlershëm me informacionin që u jepet anëtarëve të skemës, për të cilët kontributet nuk paguhen më, por që mbeten në të njëjtin shtet anëtar.

5. Shoqëria administruese sigurohet që pagesat e pensionit dhe përfitime të tjera të pagueshme sipas këtij ligji mund t'i kryhen anëtarëve ose përfituesve që ndodhen në një shtet tjetër anëtar pas zbritjes së tatimeve dhe tarifave të zbatueshme sipas legjislacionit në fuqi."

### **Neni 37**

Në nenin 89, bëhen shtesat dhe ndryshimet t me përmbajtje si më poshtë:

1. Pika 1, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

"1. Aktivet e fondeve të pensionit duhet të investohen në interesin më të mirë afatgjatë të anëtarëve and përfituesve në përputhje me qëllimin e një fondi pensioni privat, si dhe në përputhje me parimin e personit të kujdesshëm, për të siguruar, cilësinë, sigurinë, likuiditetin dhe kthimin in e portofolit në tërësi."

2. Pas pikës 1, shtohen pikat 1/1 dhe 1/2, me përmbajtje si vijon:

"1/1. Në rast konflikti interesi, shoqëria administruese siguron që vendimet e investimit të merren vetëm në interesin më të mirë të anëtarëve dhe përfituesve. Shoqëria administruese miraton dhe zbaton politika për administrimin e konfliktit të interesit, e cila mbulon edhe procesin e marrjes së vendimeve të investimit.

1/2. Në zbatim të parimit të personit të kujdesshëm, fondet e pensionit privat, duhet të marrin në konsideratë ndikimin afatgjatë të vendimeve të investimit mbi faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes."

4. Pas pikës 6, shtohen pikat 7, 8, 9 dhe 10, me përmbajtje si vijon:

"7. Duke marrë në konsideratë madhësinë, natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së institucionit të pensionit profesional (IORP) dhe fondeve të pensionit që administrojnë, Autoriteti monitoron përshtatshmërinë e proceseve të vlerësimit të kreditit, vlerëson përdorimin e referencave ndaj vlerësimeve të kreditit dhe nxit zbutjen e varësisë nga këto vlerësime, me qëllim reduktimin e mbështetjes në to.

8. Kufizimet sasiore të vendosura nga Autoriteti nuk pengojnë institucionet e pensionit profesional (IORP):

- a) të investojnë deri në 70% të aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike ose të gjithë portofolit, në rastin e skemave ku anëtarët mbajnë rrezikun e investimit, në aksione, letra me vlerë të barasvlershme me aksionet dhe obligacione korporative të pranuar për tregtim në tregje të rregulluara;
- b) të investojnë deri në 30% të aktiveve që mbulojnë provigjonet teknike në aktive të denominuara në monedha, të ndryshme nga ato në të cilat janë shprehur detyrimet;
- c) të investojnë në instrumente afatgjata dhe jo të tregtueshme;
- ç) të investojnë në instrumente të emetuara ose të garantuara nga Banka Europiane e Investimeve (BEI) në kuadër të Fondit European për Investimet Strategjike.

9. Dispozitat e pikës 8 të këtij neni nuk cenojnë të drejtën e Autoritetit për të kërkuar zbatimin e rregullave më të rrepta të investimit për institucionet e pensionit profesional (IORP) të autorizuara ose të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, në rastet kur këto rregulla justifikohen nga pikëpamja prudenciale.

10. Në rastin e veprimtarisë ndërkufitare, kur Republika e Shqipërisë është shteti anëtar pritës, për fondet e pensionit nuk zbatohen rregullat e investimit të parashikuara në pikën 9 të këtij neni."

### **Neni 38**

Në nenin 90, bëhen shtesat dhe ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:

1. Fjalja e parë e këtij neni numërohet si pika "1".
2. Shkronja "dh" ndryshohet me përmbajtje si vijon:

"dh) Në rast se shoqëria administruese vendos të përdorë derivative, në përputhje me pikën 1/3 të këtij neni, duhet të ketë politikë ose procedurë të brendshme, të cilat përcaktojnë kufizime

në lidhje me rreziqet që shoqërojnë përdorimin e tyre. Rreziqet në lidhje me përdorimin e këtyre instrumenteve duhet të jenë pasqyruar në prospektin e fondit të pensionit;”

3. Pas shkronjës “dh” shtohen shkronjat “f” dhe “g” me përmbajtje si vijon:

" f) Institucionet e pensionit profesional (IORP) dhe fondet e tjera të pensionit privat nuk mund të marrin hua, përveç rasteve kur huamarrja kryhet për qëllime likuiditeti dhe ka karakter të përkohshëm. Ato nuk mund të veprojnë si garantuese për detyrime të palëve të treta.

g) Autoriteti nuk mund t'i kërkojë institucioneve të pensionit profesional (IORP) dhe fondeve të tjera të pensionit privat të investojë në kategori të caktuara aktivesh. Me përjashtim të rasteve të rishikimit të Politikës së Investimit, Autoriteti nuk vendos kërkesa për miratim paraprak ose njoftim sistematik në lidhje me vendimet e investimit."

4. Pas pikës 1, shtohen pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3, me përmbajtje si vijon:

"1/1. Aktivitetet e fondit të pensionit investohen kryesisht në tregje të rregulluara.

1/2. Investimet në tregje të parregulluara kufizohen në nivele të kujdeshme dhe i nënshtrohen vlerësimit të thelluar dhe monitorimit të rrezikut.

1/3. Instrumentet derivative mund të përdoren vetëm nëse kontribuojnë në uljen e rrezikut të investimit ose në administrimin efikas të portofolit. Këto instrumente vlerësohen me kujdes, duke marrë në konsideratë aktivin bazë, dhe përfshihen në vlerësimin e aktiveve të fondit të pensionit, përfshirë institucionin e pensionit profesional (IORP). Fondi i pensionit dhe institucioni i pensionit profesional (IORP) shmangin ekspozimin e tepërt ndaj rrezikut që rrjedh nga një palë e vetme, nga palë që bëjnë pjesë në të njëjtin grup, nga një aktiv i vetëm ose nga operacione me instrumente derivative."

### **Neni 39**

Në nenin 91, bëhen shtesat me përmbajtje si më poshtë:

1. Pas shkronjës 'ë' të pikës 1, shtohen shkronjat 'f' dhe 'g' me përmbajtje si vijon:

"f) Investimi tek sponsori nuk mund të tejkalojë 5 % të portofolit në tërësi. Kur sipërmarrja sponsorizuese bën pjesë në një grup, investimi në sipërmarrjet e të njëjtit grup nuk mund të tejkalojë 10 % të portofolit në tërësi.

g) Kur institucioni i pensionit profesional (IORP) sponsorizohet nga më shumë se një sponsor, investimet në këto sipërmarrje kryhen në mënyrë të kujdeshme, duke marrë në konsideratë nevojën për diversifikim të përshtatshëm të portofolit."

2. Pas pikës 3, shtohet pika 4, me përmbajtje si vijon:

"4. Investimet e fondeve të pensionit në tituj të qeverisë së Republikës së Shqipërisë përjashtohen nga kërkesat e nenit 89, pika 4 dhe shkronjës “f” të pikës 1, të këtij neni."

### **Neni 40**

Në nenin 92, pika 3, shkronja “c” ndryshohet me përmbajtje si vijon:

"c) alokimin strategjik të aktiveve duke mbajtur parasysh natyrën dhe kohëzgjatjen e detyrimeve për pension, si dhe faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes,.

#### **Neni 41**

Në nenin 94, pas pikës 5, shtohet pika 6, me përmbajtje si vijon:

"6. Dhënia e huasë ndaj punëdhënësit, sponsorit, ose subjekteve të lidhura me të është e ndaluar, përveç rasteve kur autorizohet shprehimisht nga Autoriteti"

#### **Neni 42**

Në nenin 99, pika 3, ndryshohet me përmbajtje si vijon:

"3. Prospekti i fondit të pensionit u vihet në dispozicion pa pagesë anëtarëve të mundshëm përpara lidhjes së kontratës së anëtarësimit në fond, si dhe anëtarëve dhe përfituesve, nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, përmes , faqes së internetit, ose në kopje fizike."

#### **Neni 43**

Në nenin 100, pika 2, shkronja “b” ndryshohet me përmbajtje si vijon:

"b) politikën e investimeve (p.sh. specializimi sipas sektorëve gjeografikë ose industrialë), si dhe informacion mbi mënyrën se si politika e investimit merr në konsideratë faktorët mjedisorë, klimatikë, socialë dhe të qeverisjes së korporatave, si dhe mënyrën sesi këta faktorë merren në konsideratë;"

#### **Neni 44**

Në nenin 103, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Titulli i nenit ndryshon me përmbajtje si vijon:

“Vërtetimi për gjendjen e llogarisë së përfitimeve të pensionit”

2. Pikat 2 dhe 3, ndryshojnë me përmbajtje si më poshtë:

“1. Titulli i dokumentit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni duhet të përmbajë fjalët ‘Vërtetim për gjendjen e llogarisë të përfitimeve të pensionit’.

3. Dokumenti duhet të përmbajë informacion të saktë dhe të përditësuar dhe t’i vihet në dispozicion çdo anëtarë pa pagesë, nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, përmes

faqes së internetit, apo në kopje fizike, të paktën një herë në vit. Krahas informacionit të dhënë në formë elektronike, me kërkesë të tij, anëtarit i jepet edhe kopje fizike.”

#### **Neni 45**

Neni 104 ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 104

#### **Përmbajtja e dokumentit të gjendjes së llogarisë të përfitimeve të pensionit**

"1. Vërtetimi për gjendjen e llogarisë së përfitimeve të pensionit përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin e shoqërisë administruese, adresën e saj dhe të dhënat identifikuese të fondit të pensionit të anëtarit;
- b) të dhënat personale të anëtarit, përfshirë moshën ligjore të daljes në pension, moshën e pensionit të përcaktuar në skemë ose moshën e zgjedhur nga anëtari, sipas rastit;
- c) ) informacion për vlerën neto të aktiveve të akumuluar;
- ç) informacion për kthimin nga investimi për anëtarin për periudhën 12-mujore;
- d) informacion për kontributet e derdhura nga anëtari dhe/ose punëdhënësi në emër të anëtarit gjatë të paktën 12 muajve të fundit;
- dh) detajim të kostove ose tarifave të zbritura nga shoqëria administruese gjatë 12 muajve të fundit;
- e) parashikimet e përfitimeve të pensionit bazuar në moshën e daljes në pension sipas shkronjës (b), shoqëruar me një sqarim se këto parashikime nuk përbëjnë garanci dhe mund të ndryshojnë nga vlera përfundimtare e përfitimeve. Kur parashikimet bazohen në skenarë ekonomikë, ato përfshijnë të paktën një skenar bazë dhe një skenar të pafavorshëm, duke marrë në konsideratë natyrën specifike të fondit të pensionit;
- f) nivelin e financimit të skemës në tërësi, për fondet e pensionit me përfitime të përcaktuara, në rastet e veprimtarisë ndërkufitare.

2. Data e saktë së cilës i referohet informacioni i përfshirë në dokument paraqitet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme.

3. Autoriteti miraton rregulla për formatin dhe përmbajtjen e dokumentit të gjendjes së llogarisë së pensionit, si dhe për supozimet që përdoren për parashikimet e përfitimeve të pensionit, përfshirë normën vjetore nominale të kthimit nga investimet, normën vjetore të inflacionit, ecurinë e pagave në të ardhmen, si dhe supozimet për vdekshmërinë dhe kthimet nga investimi.”

#### **Neni 46**

Neni 105, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 105

#### **Informacioni që duhet t’u jepet anëtarëve përpara daljes në pension**

1. Përveç dokumentit për vërtetimin e gjendjes së llogarisë së përfitimeve të pensionit të anëtarit të fondit, të parashikuar në nenin 103 të këtij ligji, shoqëria administruese tre vjet e tre muaj përpara se anëtari të arrijë moshën për pension sipas nenit 73, pika 1, duhet të informojë anëtarin për vlerësimin aktual të llogarisë individuale, si dhe ta pajisë me opsionet për mënyrat e pagesës së pensionit, si dhe t’i japë udhëzime se si mund të zbatohet çdo mënyrë.

2. Në rastin e veprimtarisë ndërkufitare, kur shoqëria e licensuar/ regjistruar në Republikën e Shqipërisë, ofron pensione me përfitime të përcaktuara për anëtarë në një shtet tjetër anëtar, kur rregullat e skemës parashikojnë mundësinë e reduktimit të përfitimeve të pensionit, përfituesit njoftohen pa vonesë pas marrjes së vendimit që përcakton reduktimin e nivelit të përfitimeve, të paktën tre muaj përpara zbatimit të këtij vendimi.”

#### **Neni 47**

Neni 106, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

#### **“Neni 106 Informacioni shtesë**

1. Me kërkesë të anëtarit, përfituesit ose përfaqësuesve të tyre, shoqëria administruese jep të paktën informacionin shtesë të mëposhtëm:

- a) pasqyrat financiare dhe raportet vjetore të përcaktuara në nenin 110;
- b) deklaratën e parimeve të politikës së investimit të përcaktuar në nenin 92;
- c) çdo informacion tjetër në lidhje me të dhënat e përcaktuara në nenin 104 të këtij ligji.

2. Dokumenti për gjendjen e llogarisë së përfitimeve të pensionit përcakton vendin dhe mënyrën e marrjes së informacionit shtesë.

3. Autoriteti mund t’i kërkojë shoqërisë administruese që t’u vërë në dispozicion anëtarëve dhe përfituesve informacione të tjera shtesë.”

#### **Neni 48**

Pas nenit 106, shtohen nenet 106/1 dhe 106/2, me përmbajtje si më poshtë:

#### **“Neni 106/1 Informacioni për anëtarët e mundshëm**

1. Shoqëria administruese siguron që anëtarët e mundshëm, të cilët nuk anëtarësohen në mënyrë automatike në një skemë pensioni, të informohen, përpara anëtarësimit në skemë, mbi:

- a) çdo mundësi të disponueshme për ta, përfshirë alternativat e investimit;
- b) karakteristikat kryesore të skemës së pensionit, përfshirë natyrën dhe llojin e përfitimeve;
- c) mënyrën se si merren në konsideratë faktorët mjedisorë, klimatikë, socialë dhe të qeverisjes në politikën e investimeve; dhe
- ç) vendin dhe mënyrën e aksesimit të informacionit shtesë.

2. Në rastet kur anëtarët mbajnë rrezikun e investimit ose kanë të drejtë të marrin vendime investimi, shoqëria administruese u siguron anëtarëve të mundshëm informacion mbi performancën e kaluar të investimeve të lidhura me skemën e pensionit, në terma nominalë dhe realë, për një periudhë minimale prej pesë vitesh, si dhe informacion mbi natyrën, llojin, masën dhe mënyrën e llogaritjes së tarifave, kostove dhe shpenzimeve që u ngarkohen anëtarëve dhe përfituesve.

3. Shoqëria administruese siguron që anëtarët e mundshëm që anëtarësohen në skemë në mënyrë automatike të informohen menjëherë pas anëtarësimit mbi:

- a) çdo mundësi të disponueshme për ta, përfshirë alternativat e investimit;
- b) karakteristikat kryesore të skemës së pensionit;
- c) mënyrën se si merren në konsideratë faktorët mjedisorë, klimatikë, socialë dhe të

qeverisjes në politikën e investimeve; dhe  
ç) vendin dhe mënyrën e aksesimit të informacionit shtesë

### **Neni 106/2** **Informacioni që duhet dhënë përfituesve gjatë fazës së pagesës**

"1. Shoqëria administruese u siguron përfituesve, në mënyrë periodike, informacion mbi përfitimet e pensionit që u takojnë sipas skemës, si dhe mbi opsionet e disponueshme për mënyrën e pagesës së tyre.

2. Në rastet kur përfituesit mbajnë një pjesë të konsiderueshme të rrezikut të investimit, gjatë fazës së pagesës së përfitimeve, shoqëria administruese u siguron atyre, në intervale të rregullta, informacion të qartë, të saktë dhe të përshtatshëm mbi natyrën dhe ndikimin e këtij rreziku.

3. Në rastin e skemave të pensionit me përfitime të përcaktuara, shoqëria administruese informon përfituesit pa vonesë pas marrjes së një vendimi përfundimtar që sjell reduktimin e nivelit të përfitimeve të pensionit të parashikuara nga skema dhe, në çdo rast, jo më vonë se tre muaj përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi."

### **Neni 49**

Pika 2, e nenit 110, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

"2. Prospekti dhe rregullat e fondit i vihen në dispozicion anëtarit pa pagesë, nëpërmjet një mjeti të qëndrueshëm komunikimi, përmes faqes së internetit, ose kopje fizike përpara nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit ose deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes. Prospekti i përditësuar, gjithashtu, vendoset për t'u shkarkuar edhe në faqen e internetit të shoqërisë administruese."

### **Neni 50**

Në nenin 115, bëhne shtesat dhe ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me përmbajtje si vijon:

"2/1. Depozitari i autorizuar në një shtetanëtar mund të emërohet për të ushtruar funksionet e depozitarit në Republikën e Shqipërisë, pas njohjes nga Autoriteti, me kusht që bashkëpunimi efektiv ndërmjet Autoritetit dhe autoritetit përgjegjës të shtetit anëtar të origjinës të jetë i garantuar."

2. Pika 3, ndryshohet si më poshtë:

"3. Autoriteti miraton rregulla më të detajuara në lidhje me kushtet dhe kriteret për licencimin si depozitar i fondit të pensionit privat, përfshirë njohjen dhe regjistrimin e depozitarit të autorizuar në një shtet anëtar. "

### **Neni 51**

Në nenin 118, pika 1, pas shkronjës 'i' shtohet shkronja 'j' me përmbajtje si më poshtë:

"j) vepron me ndershmëri, profesionalizëm dhe pavarësi, duke ushtruar funksionet e tij në interesin më të mirë të anëtarëve dhe përfituesve të fondit të pensionit."

### **Neni 52**

Pas shkronjës 'b' të pikës 1 të nenit 119 shtohet shkronja 'c' me përmbajtje si më poshtë:

" c) Kur aktivet e një fondi pensioni nuk përbëhen nga aktivet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, depozitari verifikon të drejtën e pronësisë së fondit mbi këto aktive dhe mban një regjistër të veçantë për to. Verifikimi i së drejtës së pronësisë kryhet mbi bazën e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga shoqëria administruese dhe, sipas rastit, mbi bazën e provave ose dokumenteve të siguruara nga palë të treta. Depozitari siguron përditësimin e vazhdueshëm të regjistrit të aktiveve."

### **Neni 53**

Në nenin 123, pikat 2 dhe 4, ndryshohen me përmbajtje si më poshtë:

"2. Depozitari është përgjegjës ndaj shoqërisë administruese, fondit të pensionit dhe ndaj anëtarëve dhe përfituesve të fondit për çdo humbje të shkaktuar nga vetë ai ose nga një palë e tretë së cilës i është deleguar ruajtja e aktiveve të fondit.

4. Depozitari mban gjithashtu përgjegjësi ndaj fondit të pensionit dhe ndaj anëtarëve dhe përfituesve për të gjitha humbjet e shkaktuara si pasojë e pakujdesisë së depozitarit apo mospërbushjes së qëllimshme të detyrimeve të tij në bazë të këtij ligji dhe akteve rregullative të miratuara nga Autoriteti."

### **Neni 54**

Në nenin 143 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1, ndryshohet si vijon:

"1. Autoriteti është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e subjekteve të licencuara dhe/ose regjistruara nga ky ligj. Për qëllimet e këtij ligji, mbikëqyrje është verifikimi nëse subjekti i licencuar dhe/ose regjistruar vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji, rregulloret e miratuara në zbatim të tij, rregullat e administrimit të rrezikut, si dhe rregullat e tjera, që mundësojnë funksionimin e duhur të subjektit të mbikëqyrur."

2. në pikën 2 shkronjat 'a' dhe "b" ndryshohen si vijon:

"a) mbrojtja e interesave dhe të drejtave të anëtarëve dhe përfituesve;"

"b) sigurimi i zbatimit të dispozitave të këtij ligji për mbajtjen e sigurt, stabilitetin, shëndetshmërinë dhe parashikueshmërinë financiare të aktiveve të fondit të pensionit;"

3. Pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4, 5 dhe 6 me përmbajtje si më poshtë:

" 3. Mbikëqyrja ushtrohet mbi bazën e një qasjeje prospektive dhe të bazuar në rrezik, duke marrë në konsideratë madhësinë, natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarisë së subjekteve të mbikëqyrur dhe kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në kohë.

4. Autoriteti ushtron mbikëqyrjen nëpërmjet një kombinimi të përshtatshëm të analizës dhe mbikëqyrjes në distancë, si dhe të inspektimeve në vend. Për qëllime të identifikimit të rreziqeve, si dhe të vlerësimit të aftësisë për përballimin e situatave të vështira financiare të fondit të pensionit, Autoriteti mund të përdorë instrumente të tjera mbikëqyrëse, përfshirë provat e rezistencës (*stress-test*).

5. Në ushtrimin e kompetencave të tij, Autoriteti merr në konsideratë ndikimin e mundshëm të masave mbikëqyrëse dhe vendimeve të tij, në stabilitetin e sistemit financiar, veçanërisht në kushtet e stresit financiar ose të situatave emergjente. Në çdo rast, ka përparësi mbrojtja e interesave të anëtarëve dhe përfituesve të fondit të pensionit.

6. Për qëllime të mbikëqyrjes, Autoriteti zbaton një qasje të diferencuar, duke marrë parasysh llojin e skemës së pensionit dhe karakterin ndërkufitar të veprimtarisë, duke dalluar ndërmjet skemave vendase të pensionit me kontribute të përcaktuara dhe skemave ndërkufitare të pensionit me përfitime të përcaktuara.

4. Pika 3 ekzistuese e nenit 143, numërohet si pika 7."

### **Neni 55**

Pika 2 e nenit 145 ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

"2. Për qëllime të mbikëqyrjes, Autoriteti ka të drejtë të inspektojë të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e subjekteve të mbikëqyrura, sipas këtij ligji, përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a) vetëvlerësimet e rrezikut;
- b) deklaratën e politikës dhe parimeve të investimit;
- c) pasqyrat financiare vjetore dhe raportet vjetore të veprimtarisë;
- ç) raportet e ndërmjetme dhe informacionet periodike të brendshme;
- d) vlerësimet aktuariale dhe supozimet e përdorura;
- dh) studimet mbi përputhshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve (*asset-liability studies*);
- e) dokumentacionin që provon përputhshmërinë me politikën dhe parimet e investimit;
- ë) dokumentacionin që provon pagesën e kontributeve në përputhje me planin e përcaktuar;
- f) raportet e auditimit të pasqyrave financiare vjetore të audituesit të jashtëm; dhe
- g) informacionin mbi veprimtarinë e deleguara te palë të treta."

### **Neni 56**

Në nenin 146, pika 1, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë:

"1. Shoqëria administruese ose subjekti i themeluar në një shtet anëtar, që është njohur të administrojë një fond me pjesëmarrje të mbyllur të një sponsori në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të këtij ligji, është objekt mbikëqyrjeje nga Autoriteti. "

### **Neni 57**

Në nenin 147, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Numërtimi i pikës aktuale të nenit ndryshohet duke u renditur si pika 1.

2. Pas pikës 1, shtohen pikat 2, 3 dhe 4 me përmbajtje si vijon:

"2. Autoriteti përcakton dhe zbaton procesin e rishikimit mbikëqyrës, me qëllim vlerësimin e strategjive, proceseve dhe procedurave të raportimit të shoqërive administruese dhe të fondeve të pensionit, në funksion të sigurimit të pajtueshmërisë me kërkesat ligjore në fuqi. Procesi i rishikimit mbikëqyrës përfshin, në veçanti, elementet e mëposhtme:

- a) vlerësimin e kërkesave cilësore lidhur me sistemin e qeverisjes;
- b) vlerësimin e rreziqeve ndaj të cilave është i ekspozuar fondi i pensionit;
- c) vlerësimin e aftësisë së shoqërisë administruese për identifikimin, matjen, administrimin dhe monitorimin e këtyre rreziqeve.

3. Në rast të konstatimit të mangësive ose rreziqeve, Autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë administruese ose institucionit të pensionit privat marrjen e masave për adresimin dhe eliminimin e tyre.

4. Autoriteti miraton aktet nënligjore që përcaktojnë metodologjinë dhe frekuencën minimale të procesit të rishikimit mbikëqyrës, duke marrë parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e veprimtarive të subjektit të mbikëqyrur."

## **Neni 58**

Pas nenit 147 shtohet neni 147/1 me përmbajtje si më poshtë:

### **"Neni 147/1**

#### **Transparenca dhe llogaridhënia**

1. Autoriteti ushtron funksionet e përcaktuara në këtë ligj në mënyrë të pavarur, transparente në mënyrë të përgjegjshme dhe me llogaridhënie, duke respektuar në çdo rast mbrojtjen e informacionit konfidencial.

2. Autoriteti siguron publikimin e informacionit të mëposhtëm:

- a) tekstet e ligjeve, akteve nënligjore, rregullave administrative dhe udhëzimeve në fushën e skemave private të pensioneve, si dhe informacionin mbi zbatimin e neneve 4 dhe 5 të Direktivës IORP II;
- b) informacion mbi procesin e rishikimit mbikëqyrës;
- c) të dhëna statistikore të agreguara mbi aspektet kryesore të zbatimit të kuadrit mbikëqyrës;
- ç) objektivat kryesore të mbikëqyrjes, si dhe informacion mbi funksionet dhe veprimtaritë kryesore të Autoritetit;
- d) rregullat për sanksionet administrative dhe masat e tjera të zbatueshme në rast të shkeljeve të akteve ligjore dhe rregullatore të miratuara në zbatim të Direktivës IORP II.

## **Neni 59**

Pas nenit 148 shtohet neni 148/1 me përmbajtje si më poshtë:

### **"Neni 148/1**

#### **Sekreti profesional**

1. Të gjithë personat të cilët punojnë ose kanë punuar për pranë Autoritetit, si dhe audituesit, ekspertët apo çdo person tjetër që vepron në emër ose për llogari të tyre, janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional.

2. Personat e përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk mund të zbulojnë informacion konfidencial të marrë gjatë ushtrimit të detyrës ndaj asnjë personi apo autoriteti, përveç rasteve kur një detyrim i tillë parashikohet shprehimisht me ligj ose kur informacioni jepet në formë të përmbledhur apo agregate.

3. Detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional vijon të zbatohet edhe pas përfundimit të funksionit, detyrës ose marrëdhënies së punës.

4. Përjashtimisht, informacioni konfidencial mund të bëhet i disponueshëm në kuadër të procedurave civile ose tregtare që lidhen me likuidimin e fondit të pensionit ose të skemës së pensionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi."

## **Neni 60**

Në nenin 149, bëhen shtesat dhe ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshon me përmbajtje si vijon:

"1. Autoriteti mund të lidhë marrëveshje me çdo autoritet tjetër rregullator, vendas dhe të huaj, autoritet rregullator në sektorin financiar, organizatat ndërkombëtare, që përfaqësojnë autoritetet rregullatore financiare, institucionet përgjegjëse për garantimin e stabilitetit të sistemit financiar përmes politikave makroprudenciale, si dhe organet e ngarkuara me procedurat e likuidimit të fondeve të pensionit ose procedura të tjera të ngjashme, agjencitë ose institucione kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ose agjenci ligjzbatuese, për të shkëmbyer informacionet e nevojshme apo për të bashkëpunuar për kryerjen e veprimtarisë së mbikëqyrjes, ashtu siç është përcaktuar në këtë ligj.

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtje si vijon:

1/1. Autoriteti mund të shkëmbejë informacion me:

- a) autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e subjekteve të ngarkuara me likuidimin e fondeve të pensionit ose me procedura të tjera të ngjashme;
- b) autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e audituesve ligjorë të fondeve të pensionit, shoqërive të sigurimit dhe institucioneve të tjera financiare;
- c) aktuarët e pavarur që kryejnë vlerësime aktuariale për fondet e pensionit, si dhe autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e këtyre aktuarëve."

## **Neni 61**

Pika 3 e nenit 150, ndryshohet si më poshtë:

"3. Informacioni konfidencial trajtohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky informacion u vihet në dispozicion organeve të procedimit penal dhe organeve gjyqësore me kërkesën e tyre, si dhe mund të bëhet publik pas marrjes së pëlqimit të personit/institucionit, që e ka dhënë këtë informacion dhe/ose që preket nga ky informacion except as directed by other applicable legislation. Treguesit kryesorë të performancës për shoqëritë administruese të pensioneve dhe të fondeve të pensionit mund të

publikohen, kur një publikim i tillë ndihmon anëtarët dhe përfituesit në marrjen e vendimeve financiare lidhur me pensionet e tyre."

## **Neni 62**

Pas nenit 150 shtohen nenet 150/1, 150/2, 150/3, 150/4, 150/5, 150/6, 150/7, 150/8, me përmbajtje si më poshtë:

### **"Neni 150/1 E drejta e hetimit e Parlamentit Evropian**

Dispozitat e neneve 148/1, 149 dhe 150 nuk cenojnë të drejtën e hetimit të Parlamentit Evropian, të parashikuar në nenin 226 të Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian.

## **Neni 150/2**

### **Transmetimi i informacionit bankave qendrore, autoriteteve monetare, autoriteteve evropiane të mbikëqyrjes dhe Bordit Evropian për Rrezikun Sistemik**

1. Dispozitat për sekretin profesional nuk e ndalojnë Autoritetin që, në ushtrimin e funksioneve të tij, t'i transmetojë informacion:

- a) bankave qendrore apo institucioneve të tjera që ushtrojnë funksione të ngjashme në cilësinë e tyre si autoritete monetare;
- b) autoriteteve publike përgjegjëse për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave;
- c) Bordit Evropian për Rrezikun Sistemik, Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), Autoritetit Evropian të Mbikëqyrjes (Autoriteti Bankar Evropian) i krijuar me Rregulloren (BE) nr. 1093/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, si dhe Autoritetit Evropian të Mbikëqyrjes (Autoriteti Evropian për Instrumentet Financiare dhe Tregjet) i krijuar me Rregulloren (BE) nr. 1095/2010 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

2. Subjektet e përmendura në pikën 1 mund t'i japin Autoritetit informacion, kur një informacion i tillë është i nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të tij mbikëqyrëse.

3. Çdo informacion i transmetuar ose i marrë në zbatim të këtij neni i nënshtrohet kërkesave të sekretit profesional, të cilat duhet të jenë të paktën të barasvlershme me ato të përcaktuara në nenin 148/1 të këtij ligji.

## **Neni 150/3**

### **Vënia në dispozicion e informacionit ndaj autoriteteve publike**

1. Dispozitat për sekretin profesional nuk e pengojnë Autoritetin të vërë në dispozicion informacion konfidencial ndaj institucioneve të administratës publike ose autoriteteve publike përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit në fushën , institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare .

2. Vënia në dispozicion e informacionit sipas pikës 1 lejohet vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) është e nevojshme për qëllime të mbikëqyrjes ose për parandalimin apo zgjidhjen e fondeve të pensionit në vështirësi financiare; dhe

b) marrësit e informacionit i nënshtrohen kërkesave për sekret profesional të paktën ekuivalente me ato të përcaktuara në këtë ligj.

3. Informacioni i marrë nga autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare vihet në dispozicion vetëm me pëlqimin e shprehur të autoritetit nga i cili informacioni ka origjinën.

4. Autoriteti mund t'i vendosë në dispozicion informacion konfidencial komisioneve hetimore parlamentare, institucioneve audituese dhe organeve të tjera të ngarkuara me funksione hetimi ose mbikëqyrjeje sipas legjislacionit në fuqi, me kusht që:

a) këto institucione të kenë kompetencë ligjore për të hetuar ose shqyrtuar veprimtarinë e Autoritetit, si institucion përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensionit ose për zbatimin e legjislacionit në këtë fushë;

b) informacioni të jetë i nevojshëm për ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në shkronjën "a" të kësaj pike;

c) personat që kanë akses në informacion iu nënshtrohen kërkesave për ruajtjen e sekretit profesional, të paktën të barasvlershme me ato të parashikuara në këtë ligj; dhe

ç) kur informacioni e ka origjinën nga një shtet tjetër anëtar, ai të vihet në dispozicion vetëm me pëlqimin e shprehur të autoritetit nga i cili buron dhe vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë pëlqimi.

#### **Neni 150/4**

#### **Kushtet e shkëmbimit të informacionit**

1. Shkëmbimi, transmetimi ose vënia në dispozicion e informacionit, në zbatim të dispozitave të këtij kreu, lejohet vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) informacioni shkëmbëhet, transmetohet ose vihet në dispozicion ekskluzivisht për qëllime mbikëqyrjeje ose kontrolli;

b) informacioni i marrë i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional, në përputhje me nenin 148/1 të këtij ligji;

c) kur informacioni e ka origjinën nga një shtet tjetër anëtar, ai nuk vihet në dispozicion pa pëlqimin e shprehur të autoritetit përgjegjës nga i cili buron dhe, sipas rastit, vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë ky pëlqim.

2. Për qëllime të ruajtjes së stabilitetit dhe integritetit të sistemit financiar, Autoriteti mund të shkëmbejë informacion me autoritetet ose organet përgjegjëse për zbulimin, hetimin e shkeljeve të legjislacionit për shoqëritë tregtare, të zbatueshëm ndaj sponsorave, me kusht që:

a) informacioni të përdoret vetëm për qëllime hetimi ose kontrolli;

b) informacioni t'i nënshtrohet kërkesave për ruajtjen e sekretit profesional, të paktën të barasvlershme me ato të përcaktuara në nenin 148/1 të këtij ligji;

c) kur informacioni e ka origjinën nga një shtet tjetër anëtar, ai vihet në dispozicion vetëm me pëlqimin e shprehur të autoritetit nga i cili buron dhe vetëm për qëllimet për të cilat është dhënë ky pëlqim.

3. Kur autoritetet ose organet e përmendura në pikën 2 të këtij neni ushtrojnë funksionet e tyre me ndihmën e ekspertëve të jashtëm ose të personave që nuk janë të punësuar në sektorin publik, shkëmbimi i informacionit lejohet vetëm nëse:

a) këta persona janë të emëruar në bazë të kompetencës profesionale; dhe

b) u nënshtrohen detyrimeve për ruajtjen e konfidencialitetit, të paktën të barasvlershme me ato të parashikuara në këtë ligj.

#### **Neni 150/5**

## **Dispozitat kombëtare prudenciale**

1. Autoriteti i raporton EIOPA-s dispozitat kombëtare të lidhura me mbikëqyrjen dhe rregullimin, që janë të zbatueshme në fushën e skemave të pensionit privat, të cilat nuk mbulohen nga legjislacioni i fushës për mbrojtjen sociale dhe punën.

2. Autoriteti përditëson këtë informacion në mënyrë periodike dhe të paktën çdo dy vjet. EIOPA e publikon këtë informacion në faqen e saj zyrtare të internetit

### **Neni 150/6**

#### **Bashkëpunimi ndërmjet shteteve anëtare, Komisionit Evropian dhe EIOPA-s**

1. Autoriteti kontribuon në zbatimin e njëtrajtshëm të Direktivës IORP II nëpërmjet shkëmbimit të rregullt të informacionit me autoritetet e shteteve anëtare, me qëllim zhvillimin e praktikave më të mira, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse dhe, sipas rastit, me përfshirjen e partnerëve socialë, për të krijuar kushtet e nevojshme për ushtrimin pa pengesa të veprimtarive ndërkufitare.

2. Komisioni Evropian dhe autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare bashkëpunojnë ngushtësisht me qëllim lehtësimin e mbikëqyrjes së veprimtarisë së institucioneve të pensionit privat.

3. Autoriteti bashkëpunon me EIOPA-n për qëllimet e Direktivës IORP II, në përputhje me Rregulloren (BE) 1094/2010, dhe i vë në dispozicion, pa vonesë, të gjithë informacionin e nevojshëm për ushtrimin e kompetencave sipas Direktivës IORP II dhe Rregullos (BE) nr. 1094/2010.

4. Autoriteti informon Komisionin Evropian dhe EIOPA-n për çdo vështirësi serioze që lind gjatë zbatimit të Direktivës IORP II. Komisioni Evropian, EIOPA dhe autoritetet përgjegjëse të shteteve anëtare të përfshira shqyrtojnë këto vështirësi sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme.

### **Neni 150/7**

#### **Përpunimi i të dhënave personale**

Përpunimi i të dhënave personale nga shoqëritë administruese, fondet e pensionit, Autoriteti dhe institucionet e tjera, për qëllime të zbatimit të Direktivës IORP II, kryhet në përputhje me Rregulloren (BE) 2016/679 dhe legjislacionin vendas në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

### **Neni 150/8**

#### **Qasja në informacion në Platformën e Vetme Europiane të Aksesit (ESAP)**

1. Duke filluar nga data 10 janar 2030, Autoriteti siguron që, në rastet kur publikohet informacioni i parashikuar në nenin 23, pika 2, nenin 29 dhe nenin 30 të Direktivës IORP II, institucionet për pensionet profesionale të depozitojnë këtë informacion pranë autoritetit kombëtar përgjegjës për grumbullimin e të dhënave, me qëllim depozitim të informacionit në

Platformën e Vetme Europiane të Aksesit (ESAP), të krijuar me Rregulloren (BE) 2023/2859 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

2. Autoriteti siguron që informacioni të depozitohet në formate të lexueshme dhe të ripërdorshme, të shoqëruara me meta të dhëna standarde të identifikimit, si dhe tregues të tjerë sipas specifikimeve teknike, standardeve të metadatave, afateve dhe procedurave të depozitimit, si dhe në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian për krijimin dhe funksionimin e ESAP.

3. Autoriteti, në zbatim të këtij neni, miraton me rregullore kërkesat dhe rregullat e detajuara lidhur me procedurat, afatet e depozitimit, informacionin shoqëruar, të dhënat përshkruese dhe çdo element tjetër të nevojshëm, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian për krijimin dhe funksionimin e ESAP.

4. Deri më 9 janar 2030, për qëllime të vënies në dispozicion të informacionit të përmendur në pikën 1 të këtij neni në ESAP, caktohet të paktën një institucion grumbullues i të dhënave, sipas përkufizimit të nenit 2, pika 2, të Rregullores (BE) 2023/2859, dhe për këtë njoftohet Autoriteti Evropian për Instrumentet Financiare dhe Tregjet (ESMA).

5. Nga data 10 janar 2030, informacioni i parashikuar në nenin 48, pika 4, të Direktivës IORP II duhet të jetë i aksesueshëm në ESAP. Për këtë qëllim, institucioni grumbullues i të dhënave, sipas nenit 2, pika 2, të Rregullores (BE) 2023/2859, është autoriteti përgjegjës"

### **Neni 63**

Në nenin 177, bëhen shtesat me përmbajtje si më poshtë:

1. Pas pikës 2, shtohen pikat 2/1, 2/2, 2/3 dhe 2/4 me përmbajtje si vijon:

"2/1. Autoriteti mund të kufizojë ose të ndalojë përdorimin e lirë të aktiveve të shoqërisë administruese ose institucionit të pensionit, kur nuk krijon provigjone teknike të mjaftueshme për të gjithë veprimtarinë, në rastin kur aktivet janë të pamjaftueshme për të mbuluar provigjonet teknike, ose nuk plotëson nivelin e kërkuar të kapitalit rregullator

2/2. Autoriteti mund të ndalojë ose të kufizojë veprimtaritë e shoqërisë administruese ose të fondit të pensionit kur:

- a) interesat e anëtarëve dhe përfituesve nuk mbrohen në mënyrë të përshtatshme;
- b) subjekti nuk plotëson më kushtet e autorizimit apo të licensës;
- c) konstatohet shkelje serioze e detyrimeve ligjore ose rregullatore;
- d) në rastin e veprimtarisë ndërkufitare, nuk respektohen kërkesat e legjislacionit të mbrojtjes shoqërore dhe të punës të shtetit pritës.

2/3. Çdo vendim i Autoritetit për kufizimin ose ndalimin e veprimtarive duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë të plotë dhe t'i njoftohet menjëherë subjektit përkatës. Ky vendim i njoftohet gjithashtu EIOPA-s, e cila ia komunikon atë të gjitha autoritetet kompetente, në rastet kur bëhet fjalë për veprimtari ndërkufitare.

2/4. Me qëllim mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe përfituesve, Autoriteti mund të caktojë një administrator ose përfaqësues të posaçëm, duke i transferuar atij tërësisht ose pjesërisht kompetencat e organeve drejtuese të shoqërisë administruese, në përputhje me dispozitat e këtij ligji."

### **Neni 64**

Në nenin 181, pas pikës 5, shtohet pika 6, me përmbajtje si më poshtë:

"6. Autoriteti miraton rregullore lidhur me procedurat e emërimit të administratorit/përfaqësuesit të posaçëm."

### **Neni 65**

Në nenin 193, bëhen shtesat dhe ndryshimet me përmbajtje si më poshtë:

"1. Pika 3, shkronja 'a' përshtatet si vijon:

"a) efektive, dekurajuese dhe parandaluese; dhe"

2. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtje si vijon:

"6. Autoriteti publikon pa vonesë çdo sanksion administrativ ose masë mbikëqyrëse të vendosur për shkak të shkeljeve të këtij ligji, ndaj të cilit nuk është ushtruar ankim brenda afatit të parashikuar ligjor, duke përfshirë informacion mbi llojin dhe natyrën e shkeljes, si dhe identitetin e personave përgjegjës. Publikimi i identitetit të personave juridikë, personave fizikë apo individë mund të shtyhet, të kryhet në formë anonime ose të mos kryhet, nëse vlerësohet joproportionale, ose kur publikimi do të rrezikonte stabilitetin financiar apo do të cenonte zhvillimin e hetimeve në vijim."

### **Neni 66**

Pas nenit 203, shtohet neni 203/1 me përmbajtje si më poshtë:

#### **“Neni 203/1**

#### **Dispozita kalimtare**

1. Subjekteve të mbikëqyrura u jepet një periudhë prej 18 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji për të përshtatur aktivitetin e tyre në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në paragrafët 1 deri në 3 të nenit 90.

2. Autoriteti miraton aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e ndryshimeve dhe shtesave të parashikuara në këtë ligj brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

### **Neni 67**

#### **Hyrja në fuqi**

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

3. Shkronja “b” e pikës 1 të nenit 3, neni 3/1, pika 1 e nenit 15, nenet 20, 20/1, 20/2, 21, 21/1, 21/2, 21/3, 21/4, 21/5, 21/6 dhe 21/7, pika 2 e nenit 26, pika 8 e nenit 89, pika 3 e

nenit 115, nenet 150/1, 150/2, 150/5, 150/6 dhe 150/8, si dhe pika 2/3 e nenit 177 të këtij ligji hyjnë në fuqi në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

4. Dispozitat e këtij ligji që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së administrimit të fondeve të pensionit privat nga shoqëritë e sigurimit të jetës hyjnë në fuqi në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.